




**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË TEKNOLOGJISË**  
**SË INFORMACIONIT**



**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**  
**MBI AUDITIMIN E “SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË**  
**INFORMACIONIT” NË AGJENCINË KOMBËTARE TË**  
**MBROJTJES CIVILE**

*Tiranë, 2020*



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË**  
**KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE**

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

***“PËR AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT  
NË AKMC”***

*Tiranë, më 25.06.2020*



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË**  
**KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE**

## **PËRMBAJTJA**

<b>Nr.</b>	<b>EMËRTIMI</b>	<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>Përmbledhje Ekzekutive</b>	<b>2</b>
	<b>a</b> Përshkrimi i Auditimit	3
	<b>b</b> Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi	3
	<b>c</b> Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit	6
<b>II.</b>	<b>Hyrja</b>	<b>6</b>
	<b>a</b> Titulli	7
	<b>b</b> Marrësi	7
	<b>c</b> Objektivat dhe qëllimi	7
	<b>d</b> Identifikimi i çështjes	8
	<b>e</b> Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8
	<b>f</b> Përgjegjësitë e audituesve	8
	<b>g</b> Kriteret e vlerësimit	9
	<b>h</b> Standardet e auditimit	10
<b>III</b>	<b>Gjetjet dhe Rekomandimet</b>	<b>10-38</b>
<b>1</b>	<b>Auditimi mbi Identifikimin, Drejtimin dhe Monitorimin e Nevojave</b>	<b>10-21</b>
	<i>a</i> Verifikim i strategjisë, politikave, standardeve dhe proceseve në Agjenci	11
	<i>b.</i> Menaxhimi i riskut dhe Struktura/t e Agjencisë	13
	<i>c.</i> Procedurat e menaxhimit të ndryshimit, problemeve dhe incidenteve	15
<b>2</b>	<b>Rimëkëmbja nga Katastrofat dhe Vazhdimësia e Ofrimit të Shërbimit</b>	<b>22-31</b>
	<i>a</i> Politikat, planet dhe organizimi i vazhdimësisë	23
	<i>b</i> Kontrollat parandaluese dhe protokollat e bashkëpunimit dhe komunikimit	25
<b>IV</b>	<b>Konkluzionet dhe Rekomandimet</b>	<b>32-38</b>

### **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, zhvilloi auditimin teknologjisë së informacionit në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, nga data 22.01.2020 deri më datë 31.03.2020. Grupi i auditimit pas mbledhjes së informacionit gjatë fazës studimore nëpërmjet intervistave dhe pyetësorëve për caktimin e zonave me risk të lartë, hartoi matricat e auditimit dhe mbështetur në to hartoi programin e auditimit në përputhje me Manualin Aktiv të Auditimit. Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

#### ***I.a Përshkrimi i Auditimit:***

Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, është pjesë e planit mujor, Janar 2020 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH me vendimin nr. 145, datë 28.01.2020.

Projektimi i këtij auditimi, është bërë mbi bazën e analizës së riskut gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e elementeve kyç mbi identifikimin, drejtimin, monitorimin dhe strategjitë përkatëse.

Menaxhimin dhe vlerësimin e riskut, struktura organizacionale, standardet, politikat dhe proceset e institucionit. Kontrollat parandaluese dhe protokollet e bashkëpunimit dhe komunikimit si dhe politikat e burimeve njerëzore duke patur parasysh dhe kërkesat e Ligjit nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”.

#### ***I.b Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi:***

Gjetjet kryesore, të paraqitura në këtë Raport Auditimi në mënyrë të përmbledhur sipas drejtimeve të auditimit, rezultuan si më poshtë:

Gjetja Nr.	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi u konstatua se AKMC nuk disponon apo administron sisteme të teknologjisë së informacionit dhe infrastrukturë network-u të sajën. Pajisjet fizike që disponon AKMC (PC, printer, router), janë pjesë e infrastrukturës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe funksionojnë si pjesë e rrjetit të brendshëm të Ministrisë së Mbrojtjes. Suporti teknik, në hardware dhe software ofrohet nga njësia e IT në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes.</p> <p>- Nga auditimi mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në AKMC për vitin 2019 u konstatua se ka pasur luhatje të vazhdueshme në burimet njerëzore, shoqëruar me vende vakante të strukturës në disa prej pozicioneve të rëndësishme në drejtoritë përkatëse, veprim i cili mbart riskun e mos përbushjes së detyrave dhe funksioneve kryesore të Agjencisë. Në strukturën e re të miratuar të AKMC (miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 27, datë 03.02.2020) është parashikuar Sektori GIS, IT dhe Publikimit, në Drejtorinë e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit. Kjo strukturë duke qenë se është akoma në proces ristrukturimi dhe rekrutimi, nuk është plotësuar me punonjës/ specialist të teknologjisë së informacionit.</p>	faqe 10-21	e lartë	<p>1.1.AKMC në bashkëpunim me MM në vijimësi të kryejnë analizimin dhe prioritarizimin e nevojave mbi infrastrukturën dhe elementet e nevojshëm TIK që ndihmojnë në lehtësimin e proceseve të aktivitetit që agjencia kryen.</p> <p>1.2.Strukturat drejtuese të AKMC në bashkëpunim me MM të marrin masa për mirë menaxhimin e burimeve njerëzore duke plotësuar vendet vakante dhe të hartojnë politika për zhvillimin e tyre nëpërmjet trajnimeve. Duke qenë se AKMC është në proces ristrukturimi të tregohet kujdes në rekrutimin e stafit të ri në mbështetje të strukturës se re duke patur parasysh fushat që mbulon mbrojtja civile.</p>
2	<p>Nga auditimi u konstatua se, PKEC si dokumenti kryesor i politikave të shtetit shqiptar në fushën e emergjencave civile, për një kohë të gjatë nuk ka pasur asnjë përditësim, ku të pasqyrohen ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe në funksionet, kapacitetet dhe strukturat që bashkërendojnë veprimet e tyre në fushën e emergjencave civile duke mos i përshtatur realitetit me ndodhitë që kanë ndodhur për 16 vite në Shqipëri. Plani është i bazuar në ligjin nr. 8756, datë 26.03.2001, “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, i cili me</p>	faqe 10-21	e lartë	<p>2.1.AKMC dhe MM në bashkëpunim me strukturat përbërëse të emergjencave civile të marrin masa për përditësimin dhe miratimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile ku</p>



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË**  
**KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE**

	hyrjen në fuqi të ligjit të ri, së bashku me disa akte nënligjore ku mbështetet PKEC janë shfuqizuar.			të pasqyrohen ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe në funksionet, kapacitetet dhe strukturat që bashkërendojnë veprimet e tyre në fushën e emergjencave civile duke u mbështetur edhe në ndryshimet e ndodhura me bazën ligjore dhe nënligjore.
3	Nga auditimi u konstatua se, akoma nuk është draftuar/hartuar apo miratuar, Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë ( <i>neni 10 i ligjit nr. 45 datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen civile"</i> )	faqe 10-21	e lartë	3.1.AKMC në rolin e organit koordinues për menaxhimin e situatave të emergjencave civile, në bashkëpunim me MM dhe të gjithë palët e përfshira në proces të marrë masa për nisjen e konsultimeve me qëllim hartimin e dokumentit bazë strategjik të Republikës së Shqipërisë, Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, që përcakton politikat dhe aktivitetet e institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë, në përputhje edhe me përcaktimet e ligjit të ri "Për mbrojtjen civile".
4	Nga auditimi u konstatua mungesa e vlerësimit kombëtar të riskut, i cili përfshin një vlerësim të klasifikuar të rreziqeve që mund të ndodhin në vend gjatë viteve të ardhshme, për të ndihmuar autoritetet përgjegjëse për të informuar, planifikuar dhe përgatitur mbi ngjarjet e ndryshme.	faqe 10-21	e lartë	4.1.AKMC në bashkëpunim me MM dhe të gjithë palët e përfshira në proces të marrin masa për nisjen e konsultimeve me qëllim hartimin e dokumentit të vlerësimit të risqeve në nivel qendror, Vlerësimi i Riskut, që identifikon llojin, karakteristikën dhe prejardhjen e risqeve nga fatkeqësitë, nivelin e ekspozimit dhe të cenueshmërisë, faktorët që e shkaktojnë apo që e rrisin nivelin e mundësisë së rrezikut, si dhe pasojat e mundshme për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin. Futjen e burimeve të teknologjisë së informacionit në hartimin e politikave për burime njerëzore, burime të tjera



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË**  
**KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE**

				<p>materiale (mjetet transporti, ushqime, mjete financiare etj) për minimizimin e risqeve të mësipërme, në përputhje edhe me përcaktimet e ligjit të ri “Për mbrojtjen civile”.</p> <p>-Ky dokument të paraprihet nga realizimi i studimeve dhe marrjes në analizë të shkaqeve të mundshme të ndodhjes së këtyre fatkeqësive, faktorët që ndikojnë në përkeqësimin e situatave dhe ekspozimit të popullsisë dhe pasurive të saj ndaj këtyre faktorëve, mundësive për shmangien e tyre, etj</p> <p>4.2.Gjithashtu, në vlerësimin e risqeve të identifikohen dhe merren në konsiderate edhe risqet e mundshme në infrastrukturën kritike të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si pjesë thelbësore e këtij procesi.</p>
5	<p>Nga auditimi mbi infrastrukturën kritike u konstatua se nuk janë marrë në konsideratë bazat e të dhënave shtetërore, infrastrukturën e informatizuara dhe ajo e qendëruar në Data Center-in e vetëm që administrohet nga AKSHI, përcaktuar në nenin 43 të ligjit nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile” si infrastruktura kritike.</p>	faqe 22-31	e lartë	<p>5.1.AKMC të marrë në konsideratë si infrastrukturë kritike qendrën e të dhënave që administrohet nga AKSHI, në aktet rregullative që do të hartojë, si një sistem në të cilin jo vetëm është investuar një sasi e konsiderueshme fondesh të buxhetit të shtetit, por edhe pse është e vetmja formë për të ofruar shërbime në disa prej rasteve të emergjencave si: përmbytje, zjarr, epidemi.</p>
6	<p>Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga AKMC si dhe struktura të tjera në prefekturat e vizituara gjatë këtij auditimi, u konstatua se, nuk janë identifikuar proceset kritike si dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit sipas llojit të fatkeqësisë, nuk ka plane apo politika mbi mënyrën se si do të ofrohen shërbimet në rast ndërprerjeje.</p>	faqe 22-31	e lartë	<p>6.1.AKMC të marri masat e nevojshme për identifikimin e proceseve kritike që sigurohen nëpërmjet teknologjisë së informacionit, si shumë të rëndësishme në rastin e emergjencave civile shkaktuar nga epidemitë. Gjithashtu, të hartojë apo kërkojë nga institucioni përgjegjës për teknologjinë AKSHI, planet dhe politikat e vazhdimësisë në ofrimin</p>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

				e shërbimeve në rast emergjence.
7	Nga auditimi u konstatua se AKMC nuk disponon protokolle komunikimi të dokumentuara sipas ngjarjeve të caktuara që përcakton ligji, të cilat lidhen me dukuri natyrore ekstreme si: tërmetet, përmytjet dhe vërshimet e ujit, temperaturat ekstreme dhe të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta në tokë dhe në det, zjarret masive në pyje, sëmundjet infektive masive dhe dukuri të tjera që ndikojnë në jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.	faqe 22-31	e lartë	7.1. AKMC të marrë masa për hartimin dhe miratimin e protokolleve të komunikimit ndërmjet institucioneve si dhe krijimin e dokumentacioneve model, që do të përdoren në secilin prej emergjencave që do ndeshen në të ardhmen në secilin prej niveleve.

#### I.c Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit:

Grupi i auditimit mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH" datë 27.11.2014 konstaton se, mos përditësimi për një kohë të gjatë i Planit Kombëtar të Emergjencave Civile, mungesa e vlerësimit kombëtar të riskut dhe mungesa e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut si dhe mos menaxhimi i fazës tranzitore të reformimit që po kalon AKMC, kanë sjellë një situatë me risk të lartë në drejtim të funksionimit dhe koordinimit të të gjitha strukturave të emergjencave civile në vend.

Identifikimi, përcaktimi, vlerësimi, bashkëpunimi dhe adresimi i burimeve të teknologjisë së informacionit në mbështetje të veprimtarisë së AKMC është i pamjaftueshëm.

Gjithashtu, AKMC nuk ka konsideruar infrastrukturën kritike të qendëruara të bazave të të dhënave shtetërore si dhe qendrën e të dhënave të cilat jo vetëm janë të vetmet në vend por edhe një investim tejet i lartë në vlerë dhe rendësi.

Në gjykimin tonë ekzistenca e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, nën varësi të ministrit, e kufizon atë në ushtrimin e një roli të fortë koordinues ndaj institucioneve të tjera.

Për kapërcimin e problematikave të konstatuara në këtë raport dhe rritjes së rolit të IT në përmbushje të objektivave të Agjencisë është rekomanduar hartimi i Strategjisë Institucionale ku pjesë e saj të bëhen edhe elementët e teknologjisë së informacionit.

## II. HYRJE

Shqipëria është një vend me probabilitet relativisht të lartë të goditjes nga fatkeqësitë natyrore. Rreziqet nga fatkeqësitë natyrore për Shqipërinë janë: gjeologjike (**tërmete, rrëshqitje dheu, shkëmbinjsh**); hidrometeorologjike (**përmytje, shira të rrëmbyer, thatësira, stuhi bore, orqe apo bllokim nga bora, stuhi ere**); bio-fizike (**zjarre në pyje, epidemi**) ndërsa ato të shkaktuara nga njeriu konsistojnë në: shpërthim digash, përmytje e fatkeqësi teknologjike. Shqipëria ndeshet gjithashtu me një numër problemesh mjedisore, të cilave u shtohet ekzistenca ende e zonave me rrezik të lartë për shkak të ndotjes (**hot-spote**).

Efekti i fatkeqësive natyrore në Shqipëri amplifikohet nga mungesa e mirëmbajtjes së infrastrukturës, ndërtime të pasigurta dhe praktikë e shfrytëzimit të tokës, të lidhura këto me urbanizimin e shpejtë, shfrytëzimin e keq të burimeve natyrore (kullotave, pyjeve, shtretërve



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

të lumenjve, etj) gjatë kalimit nga një ekonomi e kontrolluar nga shteti në një ekonomi të tregut të lirë.<sup>1</sup> Atyre u shtohen mungesa e burimeve materiale dhe niveli i ulët i koordinimit midis agjencive që kanë përgjegjësi ligjore në emergjencat civile, ndërsa sistemit të edukimit dhe informimit i mungon përfshirja e nevojshme dhe influenca në institucionet shtetërore dhe në popullsinë shqiptare në tërësi.

Sistemi i emergjencave civile në Shqipëri ka evoluar me kohën por në mënyrë jo lineare. Progresi është shoqëruar herë pas here me ndalesa bile edhe me hapa prapa. Ky fakt si dhe mungesa e të dhënave të mjaftueshme e bëjnë analizën e tij të vështirë. Vlerësimi i Rrezeve nga Fatkeqësitë i vitit 2003 dhe Plani Kombëtar i Emergjencave Civile, 2004 (PKEC-04) përbëjnë dy hapa të rëndësishëm që hodhën bazat e këtij procesi, ndërsa një numër projektesh të sponsorizuara nga Banka Botërore, OKB dhe BE, midis viteve 2010 e 2014, të fokusuar në vlerësimin dhe ngritjen e kapaciteteve qenë hapa të rëndësishëm përpara, të cilat gjithashtu ofruan informacion të rëndësishëm në mënyrën se si ky sistem funksionon në Shqipëri dhe ç'mbetet për të bërë në të ardhmen<sup>2</sup>.

Përdorimi masiv i teknologjisë së informacionit në vitet e fundit tregon dobishmërinë e lartë publike e cila bazohet në modelin e ngritjes së rrjeteve të integruara por ajo që vërehet është se në sektorin e emergjencave civile dobishmëria e TIK si një aset me vlerë të veçantë nuk ka marrë vëmendjen e duhur.

Nisur nga sa më sipër, Kontrolli i Lartë i Shtetit ndërmori procesin e auditimit mbi Auditimi Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, ku Ju do të keni mundësinë njiheni me situatën e përgjithshme të rezultuar në institucionin e sipërpërmendur me anë të këtij Raporti Përfundimtar. Grupi i auditimit ka propozuar rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës dhe ofrimin e mundësive për bashkëpunim ndërmjet institucioneve që janë pjesë e këtij procesi.

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 68/3, datë 11.02.2020, miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 22.01.2020 deri në 31.03.2020, në subjektin e auditimit “Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile”, ku periudha e audituar ishte 01.01.2019 deri në 31.12.2019, u krye auditimi mbi “Auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit”, me Grup Auditimi të përbërë nga:

**II.a Titulli:** Auditimi Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, (AKMC).

**II.b Marrësi:** Ministria e Mbrojtjes / Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

**III.c Objektivat dhe qëllimi:**

*Objekti i auditimit IT* është përcaktimi dhe vlerësimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet IT në institucion, me qëllim përmbushjen e misionit të institucionit në pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe rregullatore për emergjencat civile.

<sup>1</sup> Për më tepër: IFRC, “Legjislacioni dhe RRF në nivel komunitar – Shqipëria”, 2011.

<sup>2</sup> <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/03/Menaxhimi-i-Emergjencave-Civile-ne-Shqiperi.pdf>, faqe 2



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

Qëllimi i auditimit IT është vlerësimi nëse se ekzistojnë mekanizma dhe kontrollet e duhur me qëllim parandalimin, zvogëlimin, menaxhimin dhe marrjen e masave reaguese në rastet e emergjencave civile.

#### **II.d Identifikimi i çështjeve:**

Pas marrjes së informacionit nga subjekti dhe përpunimit të tij nga grupi i auditimit kanë rezultuar si fusha me risk më të lartë si më poshtë:

##### **1. Auditimi mbi Identifikimin, Drejtimin dhe Monitorimin e Nevojave**

- Verifikim i strategjisë, politikave, standardeve dhe proceseve në Agjenci
- Menaxhimi i riskut dhe Struktura/t e Agjencisë
- Procedurat e menaxhimit të ndryshimit, problemeve dhe incidenteve

##### **2. Rimëkëmbja nga Katastrofat dhe Vazhdimësia e Ofrimit të Shërbimit**

- Politikat, planet dhe organizimi i vazhdimësisë
- Kontrollet parandaluese dhe protokollet e bashkëpunimit dhe komunikimit

#### **II.e Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:**

Me futjen në fuqi të ligjit të ri nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile” i cili efektet financiare i filloi nga data 01.01.2020, me anë të të cilit Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile është shndërruar në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Deri në fund të vitit 2017, DPEC ka qenë në varësi të Ministrisë së Brendshme, ndërsa në Janar të vitit 2018 kjo drejtori kaloi në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes.

Sipas ligjit të ri nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile” “Mbrojtja civile synon krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të zvogëluar risqet e fatkeqësive, për të parandaluar, përgatitur, përballuar fatkeqësitë dhe për t’u rimëkëmbur, nëpërmjet një sistemi të integruar dhe efikas të mbrojtjes civile në Republikën e Shqipërisë”.

Veprimtaria e institucionit zhvillohet bazuar në aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001, “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, të cilat zbatohen për aq kohë sa nuk bien në kundërshtim me ligjin nr. 45/2019, datë 18.07.2019 dhe shfuqizohen me nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në varësi të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile me seli në Tiranë mbështetet në VKM nr. 747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”.

#### **II.f Përgjegjësitë e audituesve:**

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2019 deri në 31.12.2019, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe standardeve ndërkombëtare të teknologjisë dhe auditimit TIK.

Nga Grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 68/3, datë 11.02.2020, miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, Grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislationin e fushës në të cilën operon Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme auditimi në përputhje me kohën e konsumuar në terren, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

#### *II.g Kriteret e vlerësimit:*

Kriteret e vlerësimit bazohen në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit, Manuali i Teknologjisë së Informacionit. Opinionet dhe konkluzionet e nxjerra nga auditimi janë mbështetur në Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit, janë dokumentuar në aktet e mbajtura, observacionet gjenden të reflektuara në këtë raport, gjithashtu rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Veprimtaria mbi auditimin e subjekteve të audituara në mënyrë të përmbledhur, mbështetet në bazën ligjore si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165 si dhe nenet 78,83);
- Ligji nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr.45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe aktet ligjore në zbatim të tij;
- Legjislacioni mbi Krimin Kibernetik;
- Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.8756 datë 26.03.2001 “Për emergjencat civile”;
- VKM nr. 655, datë 18.12.2002 “Për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së sistemit kombëtar të planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile”;
- VKM nr. 664, datë 18.02.2002 “Për kriteret dhe procedurat e shpalljes së emergjencës civile”;
- VKM nr. 531, datë 01.08.2003 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencave civile”;
- VKM nr. 532, datë 01.08.2003 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e departamentit të planifikimit të emergjencave civile”;
- VKM nr. 533, datë 01.08.2003 “Për pjesëmarrjen e shtetasve në parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile”;
- VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera shkaktuar nga veprimtaria njerëzore”;
- VKM nr. 965, datë 02.12.2015 “Për bashkëpunimin ndërinstucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave”;
- VKM nr. 835, datë 03.12.2004, “Për miratimin e planit kombëtar të emergjencave civile”;
- Standardet TIK;
- ISO 31000
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 3, datë 04.03.2003 “Për kriteret e përzgjedhjes së personelit të strukturave të emergjencave civile”;
- Udhëzimi nr. 15, datë 10.07.2003 “Për ngritjen e komisionit vendor të emergjencave civile në bashki dhe komuna”;
- Udhëzimi nr. 16, datë 11.07.2003 “Për ngritjen e komisionit të planifikimit të emergjencave civile në nivel qarku”;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.
- Udhëzues dhe Manuale të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit si: ISSAI 5300, Manuali Aktiv i Auditimit IT si dhe Standardet e COBIT.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

- Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit

#### **II.h Standardet e auditimit:**

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet, dhe teknika auditimi, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testim dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj.

### **III. GJETJET DHE REKOMANDIMET:**

#### **1. Auditimi mbi Identifikimin, Drejtimin dhe Monitorimin e Nevojave**

Me futjen në fuqi të ligjit të ri nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile” i cili efektet financiare i filloi nga data 01.01.2020, me anë të të cilit Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile është shndërruar në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Deri në fund të vitit 2017, DPEC ka qenë në varësi të Ministrisë së Brendshme, ndërsa në Janar të vitit 2018 kjo drejtori kaloi në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. DPEC që prej janarit 2018 e në vazhdim është në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes.

Sipas ligjit të ri nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile” “Mbrojtja civile synon krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të zvogëluar risqet e fatkeqësive, për të parandaluar, përgatitur, përballuar fatkeqësitë dhe për t’u rimëkëmbur, nëpërmjet një sistemi të **integruar dhe efikas** të mbrojtjes civile në Republikën e Shqipërisë”.

Organizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile është e strukturuar në dy Drejtori: Drejtoria e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile;

Drejtoria Operacionale e Drejtim - Komandimit të Emergjencave Civile, (ndryshe e njohur me emrin Qendra Kombëtare Operacionale).

Brenda strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile funksionon Drejtoria Operacionale e Drejtim Komandimit të Emergjencave Civile që kryen shërbim 24-orësh me funksion komandues, komunikues dhe koordinues. Drejtoria Operacionale e Drejtim Komandimit të Emergjencave Civile shërben si një qendër informacioni dhe koordinimi për emergjencat civile në Shqipëri.


Veprimtaria e institucionit zhvillohet bazuar në aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001, “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, të cilat zbatohen për aq kohë sa nuk bien në kundërshtim me ligjin nr. 45/2019, datë 18.07.2019 dhe shfuqizohen me nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në varësi të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile me seli në Tiranë mbështetet në VKM nr. 747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”.

Sipas organikës dhe strukturës së AKMC e cila funksionon në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 94, datë 30.04.2010, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”, i ndryshuar, ajo paraqitet si më poshtë:



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË**  
**KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE**



*Figura nr. 1: Organika aktuale e AKMC*

*Tabela nr.1: Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile*

Nr.	Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile	Numër, viti 2019	
		Plan	Fakt
I	Drejtor i Përgjithshëm	1	1
II	Drejtoria e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile	6	5
	Drejtor	1	-
	Specialist	2	2
	Specialist	3	3
III	Drejtoria Operacionale e Drejtim-Komandimit të Emergjencave Civile	6	3
	Drejtor	1	-
	Specialist	5	3
	<b>Gjithsej</b>	<b>13</b>	<b>9</b>

*Burimi: AKMC, përpunuar nga grupi i auditimit*

***Nga auditimi u konstatua se:***

-AKMC nuk disponon apo administron sisteme të teknologjisë së informacionit dhe infrastrukturë network-u të sajën. Pajisjet fizike që disponon AKMC (Pc, printer, router), janë pjesë e infrastrukturës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe funksionojnë si pjesë e rrjetit të brendshëm të Ministrisë së Mbrojtjes. Suporti teknik, në hardware dhe software ofrohet nga njësia e IT në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes..

- Nga auditimi mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në AKMC për vitin 2019 u konstatua se ka pasur luhatje të vazhdueshme në burimet njerëzore, shoqëruar me vende vakante të strukturës në disa prej pozicioneve të rëndësishme në drejtoritë përkatëse, veprim i cili mbart riskun e mos përbushjes së detyrave dhe funksioneve kryesore të Agjencisë. Në strukturën e re të miratuar të AKMC (*miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 27, datë 03.02.2020*) është parashikuar Sektori GIS, IT dhe Publikimit, në Drejtorinë e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit. Kjo strukturë duke qenë se është akoma në proces ristrukturimi dhe rekrutimi, nuk është plotësuar me punonjës/ specialist të teknologjisë së informacionit.

**a. Verifikim i strategjisë, politikave, standardeve dhe proceseve në Agjenci**

Me futjen në fuqi të ligjit të ri nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile” me anë të të cilit Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile shndërrohet në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile gjendja në Agjenci është në proces reformimi dhe sipas përcaktimeve të akteve ligjore. Veprimtaria e institucionit zhvillohet bazuar në aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit të vjetër të shfuqizuar nr. 8756, datë 26.3.2001, “Për emergjencat civile”, të ndryshuar, të cilat zbatohen për aq kohë sa nuk bien në kundërshtim me ligjin e ri nr. 45/2019,



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

datë 18.07.2019 dhe shfuqizohen me nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji. Ligji i ri në nenin 72 “Nxjerrja e akteve nënligjore” ka të përcaktuar periudhat kohore për përfundimin e tranzicionit dhe reformimit të Agjencisë deri në nxjerrjen e të gjithë akteve të nevojshme nënligjore dhe rregullatore për funksionimin e Agjencisë dhe strukturave të tjera lidhëse dhe bashkëpunuese siç edhe janë përcaktuar në ligjin e ri për mbrojtjen civile. Pra ngritja dhe vënia në funksion e tyre kërkon një periudhë së paku dyvjeçare, pasi kërkon aftësi dhe burime financiare.

#### • **Plani Strategjik**

Në rast se Shqipërisë do t’i duhej të përballlej me një fatkeqësi tjetër natyrore: tërmet, zjarr apo përmytje, reagimi i njësive të emergjencës civile do të ishte i njëjtë si natën e 26 nëntorit. Dhe kjo gjendje kaotike e Agjencisë për Mbrojtjen Civile do të vijojë për aq kohë që do të kërkojë ristrukturimi i saj sipas përcaktimeve Ligjit të ri “Për Mbrojtjen Civile”, që ka hyrë në fuqi gjatë vitit 2019.

#### *Nga auditimi u konstatua se<sup>3</sup>:*

- AKMC nuk ka strategji institucionale po ashtu edhe strategji për teknologjinë e informacionit, mungesa e të cilave sjell mangësi në vendosjen e prioriteteve, përqendrimin e energjisë dhe burimeve për të forcuar operacionet për të siguruar që punonjësit dhe palët e tjera të interesit po punojnë drejt qëllimeve të përbashkëta.

Mungesa e Planit Strategjik Institucional, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së AKMC duke mos pasqyruar zhvillimet Institucionale, zhvillimet TIK, objektivat institucionale lidhur me infrastrukturën, burimet e nevojshme si dhe instrumentet e nevojshëm për matjen e objektivave.

- Ndhimja, mbështetja teknike dhe logjike për komunikimet e përditshme apo komunikimet me strukturat e tjera apo me institucionet bashkëpunuese, që ndihmojnë mbarëvajtjen e punës në strukturat e Agjencisë, kryhet nëpërmjet shkëmbimeve verbale, nëpërmjet celularit ose nëpërmjet e-maileve.

- Strukturat e emergjencave civile vuajnë nga koordinimi i dobët, mungesa e informacionit, e logjistikës, fondeve dhe kapaciteteve për të ndërhyrë.

#### **Planet dhe Politikat**

Me qëllim auditimin e nivelit të administrimit të dokumentimit, të politikave dhe procedurave institucionale po ashtu dhe në lidhje me teknologjinë e informacionit në AKMC, grupi i auditimit verifikoi Planin Kombëtar për Emergjencat Civile.

Agjencia e mbështet aktivitetin e saj në Planin Kombëtar për Emergjencat Civile miratuar me VKM nr. 835, datë 03.12.2004 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile” dhe në aktet ligjore e nënligjore të cituara më lart.

#### *Nga auditimi u konstatua se:*

- PKEC për një kohë të gjatë nuk ka pasur asnjë përditësim ku të pasqyrohen ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe në funksionet, kapacitetet dhe strukturat që bashkërendojnë veprimet e tyre në fushën e emergjencave civile duke mos iu përshtatur realitetit me ndodhitë që kanë ndodhur për 16 vite në Shqipëri. Plani është i bazuar në ligjin nr. 8756, datë 26.03.

<sup>3</sup> Konkluzionet e arritura mbi këto çështje janë mbështetur mbi dokumentacionin e vënë në dispozicion gjatë fazës së auditimit në terren të vjelur nga pyetësorët, intervistat me stafin e AKMC si dhe vizitat on site në strukturat e emergjencave civile.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

2001, “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, i cili me hyrjen në fuqi të ligjit të ri, së bashku me disa akte nënligjore ku mbështetet PKEC janë shfuqizuar.

- Organizimi i strukturave përgjegjëse për emergjencat civile të përcaktuara në PKEC, i përket një konfigurimi të vjetër që prej vitit 2004, ku shumë nga strukturat qendrore (Ministritë) apo vendore (Bashkitë, Komunat) kanë ndryshuar konfigurimin apo janë suprimuar, ndryshuar, shkruirë.

- PKEC nuk parashikon ndryshimet klimaterike po ashtu edhe ngjarjet e emergjencave civile të ndodhura rishtazi për 16 vite. Me futjen në fuqi të ligjit të ri Për Mbrojtjen Civile, një nga përcaktimet kryesore që kërkon ligji është ndërtimi i Planit të Ri Kombëtar të Emergjencave Civile.

- PKEC nuk ka të parashikuar elementë të TIK, si sisteme të teknologjisë së informacionit, infrastrukturë TIK apo network, etj, që do të ndihmonin në lehtësimin e përmbushjes së misionit të strukturave të emergjencave civile në RSH.

Ajo që vihet re është që edhe në ligjin e ri Për Mbrojtjen Civile nuk janë të parashikuar ndërtimi i këtyre elementëve, sipas praktikave më të mira në botë dhe duke u përshtatur me zhvillimet e vrullshme të teknologjisë së informacionit në dobi të këtyre sektorëve kritikë për popullatën.

Neni 48 “Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të humbjeve dhe fatkeqësive”, të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”, është i vetmi nen ku përmenden disa elementë mbi TIK: “-Institucionet publike dhe subjektet private, në bazë të kërkesës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, janë të detyruara t’i japin të dhëna mbi humbjet nga fatkeqësitë, të cilat shërbejnë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile.

-Baza e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë krijohet dhe funksionon pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, sipas përcaktimit për mënyrën e mbledhjes dhe administrimit të dhënave të humbjes nga fatkeqësitë, të bërë me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit”.

- AKMC nuk ka zhvilluar dhe përcaktuar politika apo rregullore për mënyrën e menaxhimit, konfigurimit dhe përdorimit të teknologjisë së informacionit, ruajtjen e informacionit etj.

#### **b. Menaxhimi i riskut dhe Struktura/t e Agjencisë**

Për shkak të karakteristikave gjeografike të Shqipërisë, fatkeqësitë natyrore, sidomos përmytjet, zjarret dhe tërmetet, rrëshqitjet e tokës, bllokimet nga reshjet e borës janë dukuri të zakonshme. Rreziku i fatkeqësive mjedisore është në rritje për shkak të urbanizimit dhe industrializimit megjithatë nuk përjashtohen dhe kërcënimet bashkëkohore të terrorizmit dhe shfaqja e sëmundjeve të ndryshme ngjitëse, etj.

#### ***Nga auditimi u konstatua se:***

- Akoma është draftuar/ hartuar apo miratuar, Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Ndërmjet reduktimit të rreziqeve nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile, më shumë prioritet i jepet të dytës. Reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë dhe mbrojtja civile i përkasin njëra-tjetrës si masa plotësuese, të cilat duhet të merren së bashku në mënyrë që të rritet qëndrueshmëria ndaj këtyre fatkeqësive.

- AKMC nuk disponon regjistër risqesh institucional, ku të përfshinte edhe risqet mbi teknologjinë e informacionit, duke e bërë jo efektiv dhe jo eficient reduktimin e risqeve, në mospërputhje me nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

*koordinatorit të riskut në njësitë publike*". Çdo fillim viti hartohet regjistri i riskut i institucionit ku përfshihen edhe risqet për teknologjinë e informacionit dhe dërgohet në fund të muajit të parë të vitit korent në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

- Mungesa e një vlerësimi kombëtar të riskut, i cili përfshin një vlerësim të klasifikuar të rreziqeve që mund të ndodhin në vend gjatë viteve të ardhshme, për të ndihmuar autoritetet përgjegjëse për të informuar, planifikuar dhe përgatitur mbi ngjarjet e ndryshme.

Me anë të vlerësimit të rreziqeve me të cilat përballet vendi bëhet e mundur që ato të mbahen nën kontroll në situata të caktuara. Këto rreziqe përfshijnë ngjarje, të tilla si stuhi të rënda, një shpërthim sëmundjesh (epidemi), përmbajtje etj. Informimi i popullatës së rrezikuar bazohet në dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë. Në mungesë të këtij dokumenti nuk ka asnjë plan për mënyrën e informimit të tyre.

-Vlerësim i rreziqeve nuk përfshin një analizë të qartë, me skenarë të ndryshëm fatkeqësish dhe nivelet e ekspozimit të popullsisë dhe pasurive të saj ndaj secilit skenar. Strukturat e emergjencave civile i kushtojnë më shumë rëndësi reagimit pas ngjarjes dhe më pak komponentëve të tjerë.

- Nuk janë identifikuar dhe dokumentuar në mënyrë të detajuar, infrastrukturat kritike vulnerabël mbi teknologjinë e informacionit dhe komunikimit sipas përcaktimeve të nenit 43 të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjes civile" mbi telekomunikacionin (rrjetet, sistemet).

Rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve shqiptare janë të shtrira në tre nivele: qendror, prefekturë apo bashki. Megjithatë, në nivel bashkie pothuajse mungon plotësisht autoriteti për vendimmarrje në lidhje me emergjencat civile.

Po ashtu edhe në nenet 9, 10, 11, 12, 13 të ligjit nr.45/2019, datë 18.07.2019 "*Për mbrojtjen civile*" parashtrohen një sërë detyrash që Agjencia duhet të përmbushi në lidhje me vlerësimin e riskut, strategjinë kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, etj.

#### ***b.1. Struktura e Drejtorisë Operacionale e Drejtim Komandimit të Emergjencave Civile***

Struktura e Drejtorisë Operacionale e Drejtim Komandimit të Emergjencave Civile, ka në organikë 7 pozicione pune nga të cilat 4 vende janë vakante, përfshirë vendin e drejtorit, i cili është vakant prej një periudhe 6 mujore. Drejtoria ka vetëm 3 punonjës të cilët operojnë me turne me nga 24 orë secili (*gjatë këtyre 24 orëve qëndron vetëm një person pa u shkëputur nga detyra*). Kjo drejtori ka funksion komandues, komunikues dhe koordinues, ku mënyra e komunikimit me autoritetet përkatëse bëhet me anë të aparateve celulare.

Në raste emergjente mbi të cilat raportohet, p.sh në rast fatkeqësie, ku mund të nevojitet një helikopter ata do të duhet t'ia komunikojnë Forcave të Armatosura për nisjen e helikopterit në vendngjarje. Pas komunikimit të emergjencës, Drejtoria Operacionale, kërkon informacion nga strukturat nëse janë marrë masat e nevojshme në mënyrë që të bëjë përditësim të informacionit.

#### ***Nga auditimi u konstatua se:***

-Drejtorja nuk disponon një historik të ngjarjeve të ndodhura mbi emergjencat civile.

-Në rast të shkëputjes së energjisë elektrike drejtoria raporton menjëherë tek Ministria e Mbrojtjes për këtë problem në mënyrë që të merren masa. Gjatë kohës së shkëputjes së energjisë komunikimi realizohet vetëm me anë të telefonit celular.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE



*Figura nr. 2: Zyra e Drejtorisë Operacionale e Drejtim Komandimit të Emergjencave Civile, pamje on site.*

#### **c. Procedurat e menaxhimit të ndryshimit, problemeve dhe incidenteve**

Duke parë rëndësinë e AKMC si autoritet koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 45 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”, Agjencia në përbërje të strukturës së re të AKMC ka parashikuar sektorin GIS, IT dhe Publikimit, në Drejtorinë e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit, miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 27, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”. Struktura e re e miratuar është në proces ristrukturimi dhe rekrutimi.

#### ***Nga auditimi u konstatua se:***

-Mungojnë plane apo protokolle të shkruara mbi mënyrën se si bëhet koordinimi i punës në raste emergjente. Dokumentimi i këtyre protokolleve shërben për të pasur një historik mbi ecurinë e ndodhjes dhe mënyrës se si përballohet kjo ngjarje, në rast se përsëriten.

- AKMC nuk ka të dokumentuar dhe implementuar procedura të standardizuara për kontrollin e ndryshimeve në infrastrukturën institucionale. Situata në AKMC dhe në strukturat rajonale nëpër Qarqe/Prefektura, për periudhën e audituar, menaxhohet mbi baza ngjarjesh. Nuk disponohet një procedurë për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë si dhe dokumentimin e të gjithë procesit të ndryshimeve, duke përfshirë dhe incidentet që vijnë nga ndërveprimi i të dhënave me institucionet bashkëpunuese apo pjesë të strukturave lidhëse.

- Nuk ka një strukturë apo sistem të konsoliduar dixhital për monitorimin dhe lajmërimin në kohë reale të fatkeqësive.

- Nuk ka një sallë të posaçme për koordinimin dhe operacionet.

- Nuk zotëron raporte të administrimit të incidenteve, problemeve dhe disponueshmërisë;



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

Nisur nga sa më lart mbi rëndësinë e AKMC, grupi i auditimit vlerëson rëndësinë e pasjes së një portali web për mbrojtjen civile ku të përfshihen një sërë elementësh kritikë ndihmues dhe informues, etj, në shërbim të popullatës së gjerë.

Nga auditimi u konstatua se Agjencia nuk posedon Portal Web por ka vetëm një seksion të posaçëm për Drejtorinë e Emergjencave Civile si strukturë vartëse e Ministrisë së Mbrojtjes, e cila ka dy portale aktive: <http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/ministria/strukturat-vartese/dpec> dhe <http://www.mod.gov.al/index.php/ministria/strukturat-vartese/dpec>

#### ***c.1. Mbi Pozicionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile***

Në shtator të vitit 2017, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile kaloi nga Ministria e Brendshme, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. **Transferimi i varësisë nuk u shoqërua edhe me transferimin e logjistikës përkatëse që ishte investuar në kohën kur DPEC ishte në varësi të Ministrisë së Brendshme.** Edhe me futjen e ligjit të ri në fuqi “Për mbrojtjen civile” Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është serish një strukturë varësie nën Ministrinë së Mbrojtjes.

Grupi i auditimit gjatë fazës së terrenit ka zhvilluar intervista me profesionistë të vjetër të emergjencave civile nëpër prefektura dhe një nga pyetjet e ngritura ka qenë në lidhje me pozicionimin e Agjencisë. Përgjigjja ka qenë gjithmonë e njëjtë, “pozicionimi i Agjencisë është i gabuar. Sipas tyre: “Agjencia duhet të ishte në varësi direkte të Këshillit të Ministrave dhe duhet të kishte në varësi Rezervat e Shtetit dhe Drejtorinë e Koordinimit dhe Planifikimit dhe në përbërje të tyre të kenë logjistikën, buxhetin, sistemet dixhitale të informacionit etj”.

Në fakt një organizim i tillë siguron funksionim vertikal të përgjegjësisë në rast fatkeqësie, siguron një reagim të menjëhershëm, si në operacione ashtu edhe në kërkim-shpëtim. Por sipas ligjit në fuqi, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile nuk e ka një funksion të tillë, d.m.th. nuk ka përgjegjësi operacionale direkte, por vetëm koordinuese.

Protokolli i komunikimit në rast fatkeqësie është i tillë: Drejtori i Agjencisë duhet t’i drejtohet ministrit të Mbrojtjes, i cili duhet t’i drejtohet drejtorit të rezervës së shtetit për ndihma, pasi Agjencia sipas mënyrës që është krijuar, nuk ka as rezerva ushqimore nën administrim dhe as trupa operacionale. Sipas ligjit të ri strukturat operacionale janë të shpërndara në nivel qarku, ndaj dhe organizimi bëhet më i vështirë.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, duke qenë në varësi të ministrit, e kufizon atë në ushtrimin e një roli të fortë koordinues (pa përmendur rolin udhëheqës) ndaj institucioneve të tjera.

**1. Titulli i gjetjes:** Administrimi i strukturave organizative, menaxhimi i burimeve njerëzore dhe infrastruktura TIK.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se:

-AKMC nuk disponon apo administron sisteme të teknologjisë së informacionit dhe infrastrukturë network-u të sajën. Pajisjet fizike që disponon AKMC (Pc, printer, router), janë pjesë e infrastrukturës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe funksionojnë si pjesë e rrjetit të brendshëm të Ministrisë së Mbrojtjes. Suporti teknik, në hardware dhe software ofrohet nga njësia e IT në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes.

- Nga auditimi mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në AKMC për vitin 2019 u konstatua se ka pasur luhatje të vazhdueshme në burimet njerëzore, shoqëruar me vende vakante të strukturës në disa prej pozicioneve të rëndësishme në drejtorinë përkatëse, veprim i cili mbart riskun e mos përbushjes së detyrave dhe funksioneve kryesore të Agjencisë. Në strukturën e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

re të miratuar të AKMC (*miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 27, datë 03.02.2020*) është parashikuar Sektori GIS, IT dhe Publikimit, në Drejtorinë e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit. Kjo strukturë duke qenë se është akoma në proces ristrukturimi dhe rekrutimi, nuk është plotësuar me punonjës/ specialist të teknologjisë së informacionit.

**Kriteri:** Mbarëvajtja institucionale.

**Ndikimi/efekti:** Risk i mos përmbushjes së veprimtarisë institucionale dhe përgjigjes ndaj emergjencave.

**Shkaku:** Institucioni është në proces reformimi.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:**

-AKMC në bashkëpunim me MM në vijimësi të kryejnë analizimin dhe prioritarizimin e nevojave mbi infrastrukturën dhe elementet e nevojshëm TIK që ndihmojnë në lehtësimin e proceseve të aktivitetit që agjencia kryen.

-Strukturat drejtuese të AKMC në bashkëpunim me MM të marrin masa për mirë menaxhimin e burimeve njerëzore duke plotësuar vendet vakante dhe të hartojnë politika për zhvillimin e tyre nëpërmjet trajnimeve. Duke qenë se AKMC është në proces ristrukturimi të tregohet kujdes në rekrutimin e stafit të ri në mbështetje të strukturës së re duke patur parasysh fushat që mbulon mbrojtja civile.

**2. Titulli i gjetjes:** Mungesa e strategjisë institucionale si dhe koordinimi i strukturave të emergjencave civile

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se, AKMC nuk ka strategji institucionale po ashtu edhe strategji për teknologjinë e informacionit, mungesa e të cilave sjell mangësi në vendosjen e prioritetëve, përqendrimin e energjisë dhe burimeve për të forcuar operacionet për të siguruar që punonjësit dhe palët e tjera të interesit po punojnë drejt qëllimeve të përbashkëta.

-Ndihma, mbështetja teknike dhe logjike për komunikimet e përditshme apo komunikimet me strukturat e tjera apo me institucionet bashkëpunuese, që ndihmojnë mbarëvajtjen e punës në strukturat e Agjencisë, kryhet nëpërmjet shkëmbimeve verbale, nëpërmjet celularit, whatsapp ose nëpërmjet e-maileve.

- Strukturat e emergjencave civile vuajnë nga koordinimi i dobët, mungesa e informacionit, e logjistikës, fondeve dhe kapaciteteve për të ndërhyrë.

**Kriteri:** Adresimi i objektivave të qarta të institucionit.

**Ndikimi/efekti:** Mungesa e planit strategjik institucional, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së AKMC.

**Shkaku:** Mos marrja e masave të duhura.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:**

-Strukturat drejtuese në AKMC dhe MM, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni zotëron dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Institucionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit duke patur parasysh ndryshimet e ndodhura me aktet ligjore dhe nënligjore. Pjesë e këtij plani strategjik të bëhen edhe elementë të teknologjisë së informacionit.

-AKMC në bashkëpunimin me MM dhe me të gjithë strukturat e shërbimit të emergjencave civile të marrin masat për krijimin e mekanizmave të nevojshëm për automatizimin dhe ndërveprimin, komunikimin, shkëmbimit e ruajtjen e të dhënave ndërmjet strukturave të emergjencave civile bashkëpunuese në nivel qendror dhe rajonal.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

#### **3. Titulli i gjetjes:** Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se, akoma nuk është draftuar/ hartuar apo miratuar, Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (*neni 10 i ligjit nr. 45 datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen civile"*). Ndërmjet reduktimit të rreziqeve nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile, më shumë prioritet i jepet të dytës. Reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë dhe mbrojtja civile i përkasin njëra-tjetrës si masa plotësuese, të cilat duhet të merren së bashku në mënyrë që të rritet qëndrueshmëria ndaj këtyre fatkeqësive.

**Kriteri:** Reduktimi i rreziqeve nga fatkeqësitë e mundshme me qëllim parandalimin dhe marrjen e masave të nevojshme.

**Ndikimi/efekti:** Mungesa e planeve dhe politikave që përcaktojnë aktivitetet e institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore.

**Shkaku:** Mos zbatim i ligjit dhe mos menaxhimi i ndryshimit.

**Rëndësia:** E lartë

#### **Rekomandim:**

AKMC në rolin e organit koordinues për menaxhimin e situatave të emergjencave civile, në bashkëpunim me MM dhe të gjithë palët e përfshira në proces të marrë masa për nisjen e konsultimeve me qëllim hartimin e dokumentit bazë strategjik të Republikës së Shqipërisë, Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, që përcakton politikat dhe aktivitetet e institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë, në përputhje edhe me përcaktimet e ligjit të ri "*Për mbrojtjen civile*".

#### **4. Titulli i gjetjes:** Përditësimi i Planit Kombëtar të Emergjencave Civile.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se, PKEC si dokumenti kryesor i politikave të shtetit shqiptar në fushën e emergjencave civile, për një kohë të gjatë nuk ka pasur asnjë përditësim, ku të pasqyrohen ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe në funksionet, kapacitetet dhe strukturat që bashkërendojnë veprimet e tyre në fushën e emergjencave civile duke mos iu përshtatur realitetit me ndodhitë që kanë ndodhur për 16 vite në Shqipëri. Plani është i bazuar në ligjin nr. 8756, datë 26.03.2001, "*Për emergjencat civile*", i ndryshuar, i cili me hyrjen në fuqi të ligjit të ri, së bashku me disa akte nënligjore ku mbështetet PKEC janë shfuqizuar.

- Organizimi i strukturave përgjegjëse për emergjencat civile të përcaktuara në PKEC, i përket një konfigurimi të vjetër që prej vitit 2004, ku shumë nga strukturat qendrore (*Ministritë*) apo vendore (*Bashkitë, Komunat*) kanë ndryshuar konfigurimin apo janë suprimuar, ndryshuar, shkruarë.

- PKEC nuk parashikon ndryshimet klimaterike po ashtu edhe ngjarjet e emergjencave civile të ndodhura rishtazi për 16 vite. Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri Për Mbrojtjen Civile, një nga përcaktimet kryesore që kërkon ligji është ndërtimi i Planit të Ri Kombëtar të Emergjencave Civile.

- PKEC nuk ka të parashikuar elementë të TIK, si sisteme të teknologjisë së informacionit, infrastrukturë TIK apo network, etj, që do të ndihmonin në lehtësimin e përmbushjes së misionit të strukturave të emergjencave civile në RSH.

**Kriteri:** Përditësimi i PKEC ku të pasqyrohen ndryshimet e ndodhura gjatë periudhës 16 vjeçare, në funksionet, kapacitetet dhe strukturat që bashkërendojnë veprimet e tyre në fushën e emergjencave civile.

**Ndikimi/efekti:** Mungesa e përditësimit të PKEC me ndryshimet e ndodhura për një periudhë të gjatë mbi funksionet, kapacitetet dhe strukturat.

**Shkaku:** Mos përditësimi i PKEC dhe mos menaxhimi i ndryshimit.

**Rëndësia:** E lartë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

#### **Rekomandim:**

-AKMC dhe MM në bashkëpunim me strukturat përbërëse të emergjencave civile të marrin masa për përditësimin dhe miratimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile ku të pasqyrohen ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe në funksionet, kapacitetet dhe strukturat që bashkërendojnë veprimet e tyre në fushën e emergjencave civile duke u mbështetur edhe në ndryshimet e ndodhura me bazën ligjore dhe nënligjore.

**5. Titulli i gjetjes:** Mungon rregullorja e brendshme e funksionimit të institucionit.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se, AKMC nuk ka zhvilluar dhe përcaktuar politika apo rregullore për mënyrën e menaxhimit, konfigurimit dhe përdorimit të teknologjisë së informacionit, ruajtjen e informacionit etj.

**Kriteri:** Pasqyrimi i roleve, detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave të gjithsecilës strukturë.

**Ndikimi/efekti:** Mos arritjen e efektivitetit dhe efijencës institucionale.

**Shkaku:** Mos marrja e masave të nevojshme administrative.

**Rëndësia:** E mesme

#### **Rekomandim:**

AKMC në bashkëpunim me MM të marrin masa për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit të saj në nivel qendror dhe vendor, duke pasqyruar saktë dhe konkretisht rolet, detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e secilës strukturë përbërëse të saj, mbështetur edhe në përcaktimet e ligjit të ri “*Për mbrojtjen civile*” dhe strukturat e reja të miratuara.

**6. Titulli i gjetjes:** Mos vlerësim i risqeve institucional të AKMC.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se, AKMC nuk disponon regjistër risqesh institucional, ku të përfshinte edhe risqet mbi teknologjinë e informacionit, duke e bërë jo efektiv dhe jo efijent reduktimin e risqeve, në mospërputhje me nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016 “*Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve*”, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*”. Çdo fillim viti hartohet regjistri i riskut i institucionit ku përfshihen edhe risqet për teknologjinë e informacionit dhe dërgohet në fund të muajit të parë të vitit korrent në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

**Kriteri:** Plotësimi i përcaktimeve dhe kërkesave ligjore si dhe miradministrimi i risqeve institucional.

**Ndikimi/efekti:** Mos marrja e masave për identifikimin dhe analizimin e risqeve dhe mos parandalimin e incidenteve të ngjashme në të ardhmen.

**Shkaku:** Mos përmbushje e kërkesave ligjore mbi ndërtimin e regjistrit të risqeve.

**Rëndësia:** E lartë

#### **Rekomandim:**

Strukturat Drejtuese në AKMC në bashkëpunim me MM të marrin masa për ndërtimin regjistrit të risqeve institucionale me qëllim që të identifikohen, analizohen dhe kontrollohen risqet, në mënyrë që mos të vënë në rrezik përmbushjen e objektivave të institucionit në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, në të cilin të përcaktohen edhe risqet IT.

**7. Titulli i gjetjes:** Mungesa e vlerësimit në nivel qendror të risqeve të emergjencave.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua mungesa e vlerësimit kombëtar të riskut, i cili përfshin një vlerësim të klasifikuar të rreziqeve që mund të ndodhin në vend gjatë viteve të ardhshme, për



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

të ndihmuar autoritetet përgjegjëse për të informuar, planifikuar dhe përgatitur mbi ngjarjet e ndryshme.

-Vlerësim i rreziqeve nuk përfshin një analizë të qartë, me skenarë të ndryshëm fatkeqësish dhe nivelet e ekspozimit të popullsisë dhe pasurive të saj ndaj secilit skenar. Strukturat e emergjencave civile i kushtojnë më shumë rëndësi reagimit pas ngjarjes dhe më pak komponentëve të tjerë.

-Nga auditimi u konstatua se, nuk janë identifikuar dhe dokumentuar në mënyrë të detajuar, infrastrukturat kritike vulnerabël mbi teknologjinë e informacionit dhe komunikimit sipas përcaktimeve të nenit 43 të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjes civile” mbi telekomunikacionin (rrjetet, sistemet).

**Kriteri:** Hartimin e dokumentit të vlerësimit të risqeve në nivel qendror dhe plotësimi i përcaktimeve ligjore.

**Ndikimi/efekti:** Mos identifikimi i risqeve nga fatkeqësitë rrit nivelin e ekspozimit dhe të cenueshmërisë.

**Shkaku:** Mos plotësim i përcaktimeve ligjore.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:**

AKMC në bashkëpunim me MM dhe të gjithë palët e përfshira në proces të marrin masa për nisjen e konsultimeve me qëllim hartimin e dokumentit të vlerësimit të risqeve në nivel qendror, Vlerësimi i Riskut, që identifikon llojin, karakteristikën dhe prejardhjen e risqeve nga fatkeqësitë, nivelin e ekspozimit dhe të cenueshmërisë, faktorët që e shkaktojnë apo që e rrisin nivelin e mundësisë së rrezikut, si dhe pasojat e mundshme për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin. Futjen e burimeve të teknologjisë së informacionit në hartimin e politikave për burime njerëzore, burime të tjera materiale (mjetet transporti, ushqime, mjete financiare etj) për minimizimin e risqeve të mësipërme, në përputhje edhe me përcaktimet e ligjit të ri “Për mbrojtjen civile”.

-Ky dokument të paraprihet nga realizimi i studimeve dhe marrjes në analizë të shkaqeve të mundshme të ndodhjes së këtyre fatkeqësive, faktorët që ndikojnë në përkeqësimin e situatave dhe ekspozimit të popullsisë dhe pasurive të saj ndaj këtyre faktorëve, mundësive për shmangien e tyre, etj

- Gjithashtu, në vlerësimin e risqeve të identifikohen dhe merren në konsiderate edhe risqet e mundshme në infrastrukturat kritike të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si pjesë thelbësore e këtij procesi.

**8. Titulli i gjetjes:** Mungesa e planeve të veprimit dhe menaxhimi i ndryshimit.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se:

AKMC nuk ka të dokumentuar dhe implementuar procedura të standardizuara për kontrollin e ndryshimeve në infrastrukturën institucionale. Situata në AKMC dhe në strukturat rajonale nëpër Qarqe/Prefektura, për periudhën e audituar, menaxhohet mbi baza ngjarjesh. Nuk disponohet një procedurë për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë si dhe dokumentimin e të gjithë procesit të ndryshimeve, duke përfshirë dhe incidentet që vijnë nga ndërveprimi i të dhënave me institucionet bashkëpunuese apo pjesë të strukturave lidhëse.

**Kriteri:** Përcaktimi dhe dokumentimi i planeve të veprimit.

**Ndikimi/efekti:** Mos parandalimin e incidenteve të ngjashme në të ardhmen.

**Shkaku:** Mos marrja e masave përgjatë fazës tranzitore.

**Rëndësia:** E mesme



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

#### **Rekomandim:**

Strukturat Drejtuese në AKMC në bashkëpunim me MM të marrin masa për hartimin e një plan veprimi për identifikimin, raportimin, trajtimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve. Gjithashtu, të marrin masa për menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e të gjithë procesit të ndryshimeve.

**9. Titulli i gjetjes:** Mbi funksionimin e strukturave koordinuese dhe komanduese në AKMC.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se zyra që përdoret nga Drejtoria Operacionale e Drejtim Komandimit të Emergjencave Civile që ka funksion komandues, komunikues dhe koordinues në AKMC nuk ka infrastrukturën e nevojshme për monitorimin dhe koordinimin në kohë reale me anë të përdorimit të elementeve TIK. Gjithashtu struktura e drejtorisë për periudhën e audituar rezultoi me vende vakante. Ndërkohë komunikimi me autoritetet përkatëse bëhet me anë të aparateve celulare dhe me whatsapp.

**Kriteri:** Praktikrat më të mira të institucioneve homologe Evropiane.

**Ndikimi/efekti:** Vështirësi në përmbushjen e objektit institucional.

**Shkaku:** Mungesa e investimeve të nevojshme.

**Rëndësia:** E mesme.

#### **Rekomandim:**

AKMC në bashkëpunim me MM dhe të gjithë palët e përfshira në proces, në planin afatmesëm të investimeve, duke marrë në konsideratë burimet e nevojshme, të marrin masa për përmirësimin e infrastrukturës, duke krijuar një sallë operative moderne të qendëruar ku të realizohet koordinimi dhe monitorimi në kohë reale për të gjitha llojet e emergjencave në Republikën e Shqipërisë, në kohë normale dhe në kohë emergjencash, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit dhe qasjes proaktive duke u fokusuar më tepër në parandalimin dhe mbrojtjen ndaj emergjencave të mundshme, në sinkron me praktikrat më të mira si Emergency Response Coordination Centre (ERCC) dhe European Civil Protection and Humanitarian Aid Operations, struktura në të cilat ne aderojmë të anëtarësohemi.

**10. Titulli i gjetjes:** Rëndësia e portalit web.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se Agjencia nuk posedon Portal Web të sajën por ka vetëm një seksion të posaçëm për Drejtorinë e Emergjencave Civile si strukturë vartëse e Ministrisë së Mbrojtjes.

**Kriteri:** Praktikrat më të mira.

**Rëndësia:** E mesme

#### **Rekomandim:**

Strukturat drejtuese në AKMC në bashkëpunim me MM të marrin masa për përmirësimin dhe përditësimin e faqes web të MM për seksionin e AKMC për të rritur ndihmesën dhe informimin ndaj qytetarëve, duke shtuar elementë inovativ në faqen web për ta bërë atë sa më interaktive dhe ndihmëse për qytetarët. Në të ardhmen, nëse do të jetë e mundur, agjencia kombëtare e mbrojtjes civile për nga vetë rëndësia që ka, të ketë një portal web informues me të gjithë elementet që parashikon ligji i të drejtës së informimit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE


#### 2. Rimëkëmbja nga katastrofat dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit

**Rimëkëmbja nga katastrofat dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit<sup>4</sup>, kjo pikë e programit të auditimit ka për qëllim të adresojë aftësinë që AKMC, prefektura apo njësitë vendore kanë për të vazhduar funksionimin kur veprimet operacionale të përditshme janë ndërprerë për një arsye apo një tjetër. Ky plan vazhdimësie në përbërjen e tij duhet të ketë politika, procedura, dhe praktika që lejojnë një institucion / një lokalitet / një rajon / një komb të rimëkëmbet dhe të vazhdojë manualisht apo në mënyrë automatike proceset kritike që konsiderohen shërbime, pas një ndërprerjeje ose krize. Vazhdimësia e ofrimit të shërbimit konsiderohet si term gjithëpërfshirës që mbulon si rimëkëmbjen pas një katastrofe ashtu dhe rifillimin e aktivitetit operacional në çdo drejtim të tij.**

Në gjuhën e teknologjisë BCP – Bussines Continuity Plan quhet plani që do të implementohet në rastin e ndodhjes së një fatkeqësie. Këto fatkeqësi mund të vijnë si rezultat i shkaqeve natyrore por edhe njerëzore. Pyetja që shtrohet në rast emergjence është; si do të vazhdojë funksionimi i një insitucioni shtetëror ose privat? Kjo pyetje nuk do të thotë se nuk mund të përdoren laps dhe letër deri në rivendosjen në normalitet të veprimeve operacionale, pasi kjo varet nga sasia e implementimit të shërbimeve në distancë që janë zhvilluar, por ka dhe faktorë të tjerë të cilët ndikojnë në çdo institucion/biznes.

Nisur nga përcaktimi që bëjnë aktet ligjore/ nënligjore në fuqi, fatkeqësi natyrore konsiderohen: tërmetet, përmytjet, thatësitrat atmosferike të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta, zjarret në pyje dhe në mjediset e banuara, sëmundjet infektive masive, pasojat e të cilave prekin popullatën, gjënë e gjallë, pronën, mjedisin, si dhe ngjarje të tjera të shkaktuara nga dukuri natyrore.

Për çdo emergjencë apo risk të mundshëm që derivon një situatë në emergjente, një nga skemat nëpër të cilën mund të analizohen dhe implementohen zgjidhjet e problemeve të shkaktuara si rezultat i një fatkeqësie natyrore, orientuese do të ishte skema që grupi i auditimit ka konceptuar si më poshtë. Për çdo hap të analizuar, planifikuar, zhvilluar dhe implementuar duhet kryer vlerësimi nëpërmjet të cilit do të kuptohej lehtësisht se në cilin hap ka nevojë për të ndërhyrë qoftë me akte ligjore/ nënligjore/ rregullative ashtu dhe me veprimet operacionale.



<sup>4</sup> DR – Disaster Recovery and BC - Business Continuity



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

Skema e mësipërme shërben më së miri në orientimin e veprimeve të ndërmarra në fillim dhe përgjatë çdo emergjence. Me skemën e mësipërme si udhëzues do të kryhej lehtësisht monitorimi në mënyrë dinamike, pa ndërprerje, për minimizimin e risqeve dhe arritjen e objektivave sa të përgjithshëm aq edhe specifik në garantimin e mbrojtjen mbi të gjitha të jetës së njerëzve, por edhe të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile, në përputhje me nenin 1 të ligjit nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”.

Grupi i auditimit shqyrtoi gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga AKMC, nga prefektura / bashki, marrëveshjet dhe memorandumet që agjencia ka nënshkruar me institucione brenda dhe jashtë vendit.

#### **a. Politikat, planet dhe organizimi i vazhdimësisë**

Sipas ligjit në fuqi nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”, institucionet e përfshira në emergjencën civile janë ministritë, prefekturat dhe bashkitë.

Brenda më pak se një viti vendi ynë goditet nga disa fatkeqësi natyrore. Pandemia që është duke përjetuar gjithë bota, tregon se teknologjia po i shërben përdoruesve të saj, madje jo pak prej shërbimeve u orientuan drej shërbimit në distancë në vendin tonë. AKSHI sipas VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” është agjencia e shërbimit teknologjik të përqendruar shtetëror, e vetmja në vend, e cila përfaqëson pronarin shtet dhe administron çdo sistem dhe infrastrukturë hardware dhe software në fushën TIK, për institucionet dhe organet e administratës buxhetore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.

Në infrastrukturat e informatizuara janë integruar shumë shërbime, në rastin e një emergjence apo katastrofe edhe pse me një kosto të lartë pajisjet fizike mund të rivendosen, por ajo që nuk mund të rindërtohet lehtësisht janë të dhënat e sistemeve të konsideruara kritike si dhe bazat e të dhënave shtetërore. Në këtë shtim të sistemeve të informatizuara dhe rritje të shërbimeve në distancë për shtetasit shqiptarë është jo pak e rëndësishme mbrojtja e kësaj prone shtetërore, kjo dhe për arsye se në rastin pandemik me të cilin po ndeshemi aktualisht shërbimet online rezultuan domosdoshmëri.

Vetëm pas identifikimit të proceseve kritike bëhet i mundur zhvillimi i një plani për vënien në funksion të tyre. Sa më i afërt me operacionet e vërteta dhe sa më saktë të jetë me veprimet reale ky plan aq më e lehtë do të jetë për çdo institucion të rifillojë implementim të shërbimit pas një ndërprerje.

Nga auditimi mbi nivelin e bashkëpunimit me organizmat ndërkombëtar dhe organizatat homologe ndërkombëtare në kuadër të mbrojtjes civile dhe të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë, si dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit rezultoi se AKMC ka 8 marrëveshje të nënshkruara ndër vite, si më poshtë:

1. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Universitetit “EPOKA” dhe DPEC me nr. 2952 prot. Datë 16.04.2015 (për MPB) dhe nr. 160 prot. Datë 21.04.2015 (për Universitetin Epoka). Synimi i këtij memorandumi është nxitja e bashkëpunimit dypalësh nëpërmjet mbështetjes së veprimtarisë kërkimore dhe aplikative, përgatitjes së projekteve të përbashkëta si dhe zhvillimit të veprimtarive kërkimore dhe aplikative, përgatitjes së projekteve të përbashkëta si dhe zhvillimit të veprimtarive profesionale dhe trajnuese ndërmjet stafit të të dy institucioneve.

2. Marrëveshje Bashkëpunimi midis Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Rendit Publik të Republikës së Greqisë, për bashkëpunim midis shërbimeve zjarrfikëse të tyre dhe kompetencave që kanë ato në këtë fushë, me qëllim menaxhimin e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

zjarreve të mëdha dhe të fatkeqësive natyrore, si tërmete përmbytje dhe fatkeqësi të shkaktuara nga njeriu. Shkëmbimit të informacionit dhe njohurive në fushën e Mbrojtjes nga Zjarri dhe trajnimeve në përgjithësi.

3. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë për ndihmë reciproke në rast të fatkeqësisë dhe aksidenteve të mëdha. Kjo marrëveshje rregullon kushtet për ndihmë vullnetare në rast të fatkeqësive apo aksidenteve të mëdha, e cila sigurohet me kërkesën komunikuar nëpërmjet kanaleve diplomatike ose me kërkesën e autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese. Referuar Paragrafit 1 të Nenit 3, të kësaj marrëveshjeje, duke dërguar ekipet e ndihmës, individë të dërguar për ndihmë ose duke ofruar materiale apo informacione për ndihmë.

4. Memorandum Bashkëpunimi midis Organit Kombëtar të Investigimeve të Incidenteve dhe Aksidenteve Ajrore në Aviacionin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile të Republikës së Shqipërisë lidhur me Bashkëpunimin dhe Asistencën në Rastin e një Incidenti/Aksidenti të Rëndë në Fushën e Aviacionit Civil. Qëllimi i këtij Memorandum bashkëpunimi është rritja e efikasitetit në kryerjen e detyrës e të dy palëve, në rast të një incidenti/ aksidenti të rëndë duke: Njohur qëllimin e OKIIA për të përmirësuar sigurinë e popullsisë dhe në të njëjtën kohë duke pranuar metodat që OKIIA përdor për t'ia arritur këtij qëllimi.

5. Marrëveshje midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë mbi ndihmën e ndërsjellët në rast të katastrofave ose të fatkeqësive të mëdha. Kjo marrëveshje rregullon kushtet e ndihmës vullnetare në rast të katastrofave ose të fatkeqësive të mëdha që do të jepet mbi bazën e një kërkesë të parashtruar në rrugë diplomatike ose nga autoritetet e palës tjetër kontraktuese.

6. Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile (DPEC) Ministria e Mbrojtjes dhe Institutit të Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), Universiteti Politeknik i Tiranës për (Bashkëpunimin, komunikimin dhe shkëmbimin e të dhënave, me qëllim përmirësimin e parashikimit, paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit dhe alarmit.

7. Marrëveshje ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile dhe Qendrës Vullnetare të Emergjencave Civile “Për një partneritet në fushën e parapërgatitjes dhe përgjigjes ndaj emergjencave civile”. DPEC (nr. 2065, datë 16.03.2015) Për Qendra Vullnetare e Emergjencave Civile (nr. 829, datë 16.03.2015). Kjo marrëveshje rregullon kushtet për ndihmë vullnetare në rast të fatkeqësive apo aksidenteve të ndryshme, e cila sigurohet me koordinimin nëpërmjet DPEC dhe QVEC sipas kërkesave të autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje, duke dërguar ekipet e ndihmës, individë të dërguar për ndihmë ose duke ofruar materiale apo informacione për ndihmë.

8. Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Sigurisë të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë për menaxhimin e katastrofave. Hartuar në Bruksel me datë 14.05.2013, në gjuhët zyrtare të Bosnje-Hercegovinës (boshnjake, kroate dhe serbe), në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Qëllimi i Memorandumit të mirëkuptimit është të krijoje kuadrin efektiv për bashkëpunim në fushën e menaxhimit të fatkeqësive.

Marrëveshjet ndërkombëtare mbi mbrojtjen civile, bazuar në nenin 17 të ligjit nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile” ratifikohen në kuvend.

Vazhdimësia dhe rivënia në funksion e shërbimeve të caktuara që mund të ndërpriten si rezultat i një fatkeqësie, kërkon së pari identifikim të proceseve specifike si më të rëndësishëm dhe



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

burimet e nevojshme për vënien në funksion, kjo sepse shërbimet nuk mund të kenë ofrim të pjesshëm.

- Nga auditimi rezulton se Aktet ligjore të pa përshtatura me ndryshimet që ka patur vendi ynë në lidhje me sistemet e informacionit nuk kanë bërë të mundur që të kryhen vlerësime apo klasifikime mbi veprime operacionale kritike që disponojmë. Proceset kritike nuk rezultojnë të jenë dokumentuar edhe në rastin kur shërbimi ofrohet me letër e jo më elektronike.

#### **b. Kontrollat parandaluese dhe protokollet e bashkëpunimit dhe komunikimit**

Ngjarjet lidhur me tërmetin e 21 shtatorit dhe nëntorit 2019 të cilët shkaktuan një emergjencë civile në përmasa të mëdha, por dhe pandemia e vitit 2020 po e sfidojnë ekonominë dhe zhvillimin e pritshëm në vendin tonë.

Nga auditimi mbi aktet në fuqi, rezulton se AKMC nuk disponon ndonjë listë ekspertësh me tituj shkencorë dhe kontribute profesionale në shoqërinë tonë, të cilët mund të jenë pjesë e emergjencave civile me qëllim kontributin në parandalimin, zvogëlimin e përmasave të një ngjarje të mundshme emergjence, duke qenë se vendin tonë e prekin disa brenda një viti si tërmetet, zjarret, përmytjet.

Me kontrolle parandaluese bazuar në aktet ligjore në fuqi, kuptohet një kuadër masash që merren para ndodhjes së një ngjarjeje për shmangien ose zvogëlimin e dëmeve që mund të vijnë si rezultat i një situatë të caktuar.

Nga auditimi rezulton se të dhënat e vetme të cilat mund të konsiderohen si kontrolle parandaluese janë të dhënat që IGJEUM bazuar dhe në memorandumimin e mirëkuptimit ndërmjet dy institucioneve, i komunikohen AKMC, si dhe strukturave të emergjencave civile në nivel qarku, me qëllim paralajmërimin e hershëm, monitorimin, njoftimin dhe alarmin. Vetë specialistët shprehen se ky komunikim kryhet me e-mail nga IGJEUM në drejtim të AKMC, strukturave rajonale në prefekturë dhe atyre në bashki.

Ligji nr. 45, datë 18.07.2019 “*Për mbrojtjen civile*”, përcakton si organ të përhershëm komitetin ndërministror për emergjencat civile në përballimin e një situatë në nenin 19 të tij. Roli kryesor i agjencisë është parandalimi dhe zvogëlimi i riskut në një emergjencë civile. **Sipas nenit 23/pika 3 të këtij ligji, AKMC ushtron autoritet koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile. Pra nga sa përshkruhet në ligj roli primar i agjencisë është të qenit proaktive në shërbim të rolit kryesor përmendur më sipër.**

Grupi i auditimit planifikoi të zhvillonte takime me përfaqësues të strukturave të emergjencave civile në qarkun Tiranë, Fier, Vlorë, Shkodër, Lezhë, Berat dhe Kuçovë me qëllim identifikimin e problematikave në komunikim dhe bashkëpunim ndërmjet strukturave dhe koordinimin që ato kryejnë në rastet e nevojshme. Takimi në qarkun Berat nuk arriti të përfundonte për shkak të ndërprerjes së qarkullimit në vend me shpalljen e pandemisë nga OBSH.

Aktet më kryesore ligjore mbi të cilat strukturat e emergjencave civile në nivel qarku, mbështesin punën e tyre në parandalim, monitorim dhe përballje të emergjencave civile në rajonin e tyre, disa prej të cilave po i përmendim më poshtë:

- Ligji nr. 45, datë 18.07.2019 “*Për mbrojtjen civile*”.
- Ligji nr. 107/2016, datë 27.10.2016 “*Për prefektin e qarkut*”.
- VKM nr. 655, datë 18.12.2002 “*Për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së sistemit kombëtar të planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile*”.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

- VKM nr. 664, datë 18.12.2002 “Për kriteret dhe procedurat e shpalljes së emergjencës civile”.
- VKM nr. 654, datë 18.12.2002 “Për përcaktimin e tarifave për përdorimin e përkohshëm nga organet shtetërore në situata emergjente, të çdo mjetei privat”.
- VKM nr.531, datë 01.08.2003 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencave civile”.
- VKM nr. 533, datë 01.08.2003 “Për pjesëmarrjen e shtetasve në parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile”.

Ajo që konstatohet menjëherë është fakti se aktet ligjore nuk janë përditësuar për më shumë se 15 vjet duke mos konsideruar jo vetëm nevojat nisur nga emergjencat që ka patur vendi ynë gjatë këtij 15 vjeçari, por përditësimi ka munguar edhe në lidhje me kostot që mund të përballet në çdo rast fatkeqësie cilado strukturë lokale apo rajonale, duke ju referuar saktësisht VKM nr. 654, datë 18.12.2002 “Për përcaktimin e tarifave për përdorimin e përkohshëm nga organet shtetërore në situata emergjente, të çdo mjetei privat”.

#### **Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në Qark (KPPECQ):**

Detyrat e këtij komisioni janë:

- Bashkërendon veprimet institucionale të nevojshme në të gjitha etapat e përgjigjes ndaj emergjencës civile.
- Bashkërendon veprimet e strukturave në nivel Rajonal me veprimet dhe aktivitetet e strukturave lokale, të vullnetareve dhe të donatorëve të ndryshëm.
- Vlerëson nevojat materiale dhe financiare, dëmtimet e shkaktuara, kostot e rehabilitimit të Rajonit të prekur nga fatkeqësia dhe kërkon mbështetjen e strukturave të tjera qendrore në nivel Rajonal.
- Bashkërendon forcat operacionale të përfshira dhe grupet e ndihmës dhe ato vullnetare të cilat veprojnë në rajon me organet e pushtetit vendor.

**Në prefekturën Tiranë,** sektori i Emergjencave Civile përbëhet nga 1 përgjegjës sektori dhe 3 specialist, e cila rezultoi të ishte e plotësuar.

**Në bashkinë Tiranë,** drejtorja e emergjencave civile është një strukturë e cila përbëhet nga 6 punonjës me një ndarje të tillë: 1 drejtor drejtorie, 1 përgjegjës sektori dhe 4 specialistë.

Trajnimet për vitin 2019:

Data 27 mars 2019 – Tiranë - Për të demonstruar shërbimet One Stop Shop. “Shërbimi, Përfitim Ndihme Financiare në Rast Fatkeqësie Natyrore”. Ky trajnim është organizuar nga STAR II.

Data 15 – 17 prill- Beograd - “ Mbi planifikimi, përgatitjen dhe koordinimin e evakuimit emergjent”. Ky trajnim është organizuar nga Ministria e Brendshme e Serbisë, në kuadër bashkëpunimit të Evropës Juglindore.

Data 29 maj 2019- Tiranë - “Strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm 2018-20212” - vendosja e objektiva, planet vjetore, mujore dhe realizimi i tyre. ky trajnim është organizuar nga drejtorja e planifikimit strategjik dhe jetësimi të prioritetëve në bashkëpunim me drejtorinë e trajnimit dhe zhvillimit në bashkinë e Tiranës.

Data 30 maj 2019 – Tiranë - “Sistemi i dixhitalizimit të vlerësimit të performancës”. Ky trajnim është organizuar nga drejtorja e trajnimit dhe zhvillimit në bashkinë e Tiranës.

Data 22 korrik 2019 – Tiranë - “Sistemet e komandimit të incidentit”. Programi CBRN. Ky trajnim është organizuar nga Ministria e Mbrojtjes me trajnues nga USA.

Tetor 2019 – Fushë Krujë- “Joint Reaction - 2019”. Ky trajnim është organizuar nga Ministria e Mbrojtjes. Stërvitje e përbashkët e vendeve të Rajonit- Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Kroacia, Bosnje & Hercegovina, Mali i Zi.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

Manovra Stërvitore e organizuar nga Drejtoria e Emergjencave Civile, Bashkia Tiranë :  
“Programi i demonstrimit në terren mbi veprimet e ndërhyrjes për situatat emergjente që mund të shkaktohen nga tërmeti” - Shkolla “Betim Muço”, rr. Shaban Bardhoshi, Kombinat.  
Pjesëmarrjes : Përfaqësues të Prefekturës së Qarkut Tiranë, Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Policisë Bashkiake, Drejtorisë së Medias Bashkia Tiranë, Shkollës “Betim Muço” (Mësues- Nxënës- Prindër), njësisë administrative nr.6, Qendrës Vullnetare të Emergjencave Civile etj.

Panairi i organizuar nga Bashkia Tiranë në datën 24-25-26 Nëntor 2019 në kuadër të ekspozimit të burimeve njerëzore dhe asetëve të Drejtorisë së Emergjencave Civile.

**Në prefekturën Vlorë**, struktura është 1 përgjegjës + 2 specialist. Që prej shtatorit 2019 struktura është vetëm me përgjegjësin pasi 2 specialistët kanë dalë në pension.

Trajnimet e zhvilluara nga punonjësit në Vlorë:

Në muajin Prill 2019 në Vlorë, trajnim me strukturat e Mbrojtjes Civile të Prefekturës si dhe bashkive Vlorë, Himarë dhe Selenicë lidhur me procedurat për plotësimin e anës dokumentare të VKM nr.329 datë 16 është zhvilluar.05.2012 me temë “kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore”.

Në muajin Maj 2019 nga Përgjegjësi i sektorit të mbrojtjes Civile është zhvilluar kursi dy javor i detyrueshëm i ASPA pranë DAP (për marrjen e statusit të nëpunësit civil).

Në muajin Shtator 2019 është zhvilluar në Vlorë trajnim nga QNOD me temë “ndotja detare e shkallës së II<sup>të</sup>, ndotja nga hidrokarburet”.

**Në prefekturën Fier**, sektori i planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile dhe krizave, ka në përbërje 4 persona, nga të cilët njëri përgjegjës dhe tre të tjerë specialist. Ky sektor në administratën e Prefektit ka funksionuar dhe vazhdon vetëm me një person, pasi përgjegjësi që u caktua me funksion politik, kryetar i PS në bashkinë Roskovec, pas 28 muaj që ka ushtruar këtë funksion, është larguar nga kjo detyrë, pasi Shërbimi Civil e ka cilësuar në kundërshtim me kriteret e pozicionit të punës. Gjatë kësaj periudhe prej 18 muaj, ky pozicion rezulton vakant dhe nuk është proceduar akoma nga institucioni prefektit të qarkut Fier dhe DAP, për zëvendësimin e tij. Ndërsa dy punonjësit e tjerë janë të atashuar në nënprefekturat e Lushnjës dhe Mallakastrës, me detyrë monitorimi dhe informimi, të pa angazhuar në proceset e tjera shpresore të sektorit dhe institucionit të prefektit.

**Në prefekturën Lezhë**, Sektori i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave ku në përbërjen e tij janë një Përgjegjës sektori dhe dy specialistë.

Trajnimet e zhvilluara nga punonjësit:

Në datën 22.01.2019, në qytetin e Durrësit, u organizua trajnimi, nga Qendra Ndër institucionale Operacionale Detare, mbi projektin: “Për një mjedis detar të pastër dhe të sigurt”, me financim nga PNUD-i, dhe projekt Menaxher në Ambasadën Kroate.

Në datat 23-26.04.2019, u organizua në Njësinë Administrative Rubik, bashkia Mirditë, trajnim, në zbatim të projektit të Bashkimit Evropian, mbi tërmetin. Pjesëmarrjes ishin, trajnuesit e projektit të Komisionit Evropian, (Drejtorja e Përgjithshme për Mbrojtjen Civile Evropiane dhe Operacionet e Ndihmës Humanitare) në Bruksel, përfaqësues të Sek. PPMC&K, të Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë dhe të bashkisë Mirditë.

Në datën 15.05.2015, marrë pjesë në takimin e organizuar në ambientet e bibliotekës të qytetit Lezhë, mbi masat që duhet të merren në luftën kundër kultivimit dhe asgjësimit të bimëve narkotike. Morën pjesë Komiteti dhe Specialistët e Task Forcës, në shkallë qarku.

Në datat 13, 21, 28.06.2019, së bashku me Prefektin, marrë pjesë në takime pune; “Për përmbajtjen në qendër të lagjes “Besëlidhja”, qyteti Lezhë”, si dhe marrë kontakte me konsulentin Bernhard Fischer, Menaxher i Projektit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

Në datat 24, 25.06.2019, me ekipin e organizuar me urdhër të Prefektit, marr pjesë në monitorimin e vijës bregdetare mbi masat e marra për fillimin e sezonit turistik veror.

Në datat 02-05 Korrik 2019, në kuadër të projektit të Bashkimit Evropian “Mbështetja e Vendit Pritës”, ushtrim në tavolinë, u zhvillua në Rubik, Mirditë, trajnimi ku morën pjesë përfaqësues nga strukturat e emergjencave civile dhe mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, etj.

Në datat 30.07.2019, marrë pjesë në trajnimin “Projekti 3 Watch out”, model trepalësh për mbrojtjen civile, organizuar nga Këshilli i Qarkut Lezhë, në bibliotekën “At Gjergj Fishta” të qytetit Lezhë.

Në datën 08.10.2019, në ambientet e QNOD, Plepa Durrës, marrë pjesë në përgatitjen paraprake të stërvitjes stimuluese “Redon 19” me temë “Reagimi ndaj ndotjes detare”.

Në datën 21-24.10.2019, marrë pjesë në stërvitjen “Joint Reaction 2019”, bazuar në urdhrin e Kryeministrit nr. 177, datë 09.12.2018”Për ngritjen e grupit ndërinstitucional për përgatitjen dhe zhvillimin në vendin tonë të stërvitjes rajonale për mbrojtjen civile, të koduar “Joint Reaction 2019”.

**Në prefekturën Shkodër,** Sektori i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave ku në përbërjen e tij janë një Përgjegjës sektori dhe dy specialistë. Aktualisht struktura është e paplotësuar pasi kishte vetëm një specialist dhe një përgjegjës, ndërsa pranë bashkive kishte Drejtori të Emergjencave Civile në Bashkinë Shkodër, dhe në katër bashkitë e tjera, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë Arrë emergjencat ishin sektor.

**1.Titulli i gjetjes.** Qendra e të dhënave (Data Center) nuk bën pjesë në infrastrukturën kritike.

**Situata:** Nga auditimi mbi infrastrukturën kritike u konstatua se nuk janë marrë në konsideratë bazat e të dhënave shtetërore, infrastrukturat e informatizuara dhe ajo e qendëruar në Data Center-in e vetëm që administrohet nga AKSHI, përcaktuar në nenin 43 të ligjit nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile” si infrastruktura kritike.

**Ndikimi/efekti:** Data Center si infrastrukturë kritike mbetet jashtë vëmendjes në zbatimin e politikave në lidhje me mbrojtjen e pronës shtetërore.

**Shkaku:** -

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** AKMC të marrë në konsideratë si infrastrukturë kritike qendrën e të dhënave që administrohet nga AKSHI, në aktet rregullative që do të hartojë, si një sistem në të cilin jo vetëm është investuar një sasi e konsiderueshme fondesh të buxhetit të shtetit, por edhe pse është e vetmja formë për të ofruar shërbime në disa prej rasteve të emergjencave si: përmbajtje, zjarr, epidemi.

**2.Titulli i gjetjes.** Mungesë komunikimi ndërmjet AKMC dhe AKSHI-t.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se AKMC nuk ka ndërmarr asnjë hap komunikimi me AKSHI-n, nisur nga roli i saj parandalues, me qëllim:

a. Konsultimin mbi zhvillimin e teknologjisë apo sistemeve që do t’i shërbenin emergjencave civile në të gjithë strukturat e vendit.

b. Identifikimin e infrastrukturës kritike si dhe risqeve në pronën shtetërore që AKSHI ka në administrim, si bazat e të dhënave shtetërore si dhe sisteme e infrastruktura të institucioneve dhe organeve të administratës buxhetore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave me anë të të cilave ofrohen dhe shërbime në distancë.

c. Identifikimin dhe prioritarizimin e shërbimeve që mund të realizohen në distancë, në rastin e një emergjence civile.

d. Hartimin e politikave dhe planeve për ofrimin e shërbimeve online në vend me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së shërbimit për shtetasit.

e. Ndërtimin e një baze të dhënash me humbje nga fatkeqësitë si dhe impaktet prej tyre.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

f. Sigurimin se të gjitha institucionet dhe Agjencitë shtetërore që ofrojnë shërbime kritike nëpërmjet sistemeve elektronike si: kontrolli kufitar, kontrollet doganore, pagesat e thesarit, sistemi tatimor, sistemi i sigurimeve shoqërore, kujdesi shëndetësor, arsimit etj, kanë ndërtuar procese BCP/DRP si një detyrim për vazhdimësinë e shërbimit ndaj qytetarëve.

**Ndikimi/efekti:** Mbeten jashtë rëndësisë infrastruktura teknologjike të vetmet në vend dhe të një rëndësie kritike.

**Shkaku:** -

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** AKMC në bashkëpunim me AKSHI-n si institucion përgjegjës i zhvillimeve teknologjike të iniciojë identifikimin e infrastrukturave kritike, prioritarizimin e shërbimeve që duhet të ofrohen në distancë, garantimin dhe ruajtjen e të dhënave në sistemet kritike dhe çdo element i teknologjisë që nevojitet të jetë i vazhdueshëm në menaxhimin e një emergjence civile.

**3.Titulli i gjetjes.** Mungesë planesh të dokumentuara për evakuim, mungesë identifikimi të proceseve kritike dhe vazhdimësisë në çdo nivel kombëtar, rajonal, lokal.

**Situata:** Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga AKMC si dhe struktura të tjera në prefekturat e vizituara gjatë këtij auditimi, u konstatua se:

a. Nuk disponojnë plane evakuimi të miratuara, plane rikuperimi apo plane vazhdimësie në asnjë prej niveleve kombëtar, rajonal apo lokal.

b. Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga AKMC si dhe struktura të tjera në prefekturat e vizituara gjatë këtij auditimi, u konstatua se, nuk janë identifikuar proceset kritike si dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit sipas llojit të fatkeqësisë, nuk ka plane apo politika mbi mënyrën se si do të ofrohen shërbimet në rast ndërprerjeje.

c. Bashkëpunimi ndërmjet subjekteve shtetërore dhe private bazuar në nenin 14, pika 8 të ligjit nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”, ende nuk ka filluar.

**Ndikimi/efekti:** Mungesa e standardeve përbën risk në reagimin e duhur të çdo emergjence.

**Shkaku:** -

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** AKMC të marri masat e nevojshme për identifikimin e proceseve kritike që sigurohen nëpërmjet teknologjisë së informacionit, si shumë të rëndësishme në rastin e emergjencave civile shkaktuar nga epidemitë. Gjithashtu, të hartojë apo kërkojë nga institucioni përgjegjës për teknologjinë AKSHI, planet dhe politikat e vazhdimësisë në ofrimin e shërbimeve në rast emergjence.

**4.Titulli i gjetjes.** Mungesë të identifikimit të risqeve si dhe protokolle të komunikimit.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se:

a. Mungojnë identifikimi i risqeve dhe protokolle të komunikimit për risqet e identifikuar nga emergjencat civile. Një protokoll i nisur ka mundësi të përmirësohet, por një protokoll komunikimi ende i pa nisur, pengon në kohë përballim e çfarëdo situatë emergjente që mund t'i duhet të kalojë vendit tonë në nivele të ndryshme lokal/ rajonal/ kombëtar.

b. AKMC nuk disponon protokolle komunikimi të dokumentuara sipas ngjarjeve të caktuara që përcakton ligji, të cilat lidhen me dukuri natyrore ekstreme si: tërmetet, përmbytjet dhe vërshimet e ujit, temperaturat ekstreme dhe të tej zgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta në tokë dhe në det, zjarret masive në pyje, sëmundjet infektive masive dhe dukuri të tjera që ndikojnë në jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

**Ndikimi/efekti:** Mungesë protokollit në menaxhimin e situatave të ngjashme.

**Shkaku:** -

**Rëndësia:** E lartë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

**Rekomandimi:** AKMC të marrë masa për hartimin dhe miratimin e protokolleve të komunikimit ndërmjet institucioneve si dhe krijimin e dokumentacioneve model, që do të përdoren në secilën prej emergjencave që do ndeshen në të ardhmen në secilin prej niveleve.

**5.Titulli i gjetjes.** AKMC nuk disponon regjistër ngjarjesh të konsideruara emergjente të ndodhura apo të raportuara sipas shpërndarjes gjeografike.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se AKMC nuk disponon regjistër ngjarjesh të konsideruara emergjente të ndodhura apo të raportuara sipas shpërndarjes gjeografike, që ato kanë pasur brenda vendit. Të dhënat e pakta në excel të regjistruara janë nën përgjegjësinë morale të çdo punonjësi në strukturat rajonale. Grupi i auditimit vuri re se vetë punonjësit në Fier, Tiranë, nën përgjegjësinë e tyre individuale kanë regjistruar të dhëna për aq kohë sa ata kanë në kryerjen e detyrës së lidhur me emergjencat, por nuk disponojnë të dhëna nga e kaluara.

**Ndikimi/efekti:** Mungesa e të dhënave historike mbi ngjarje të ndryshme të cilat do të ndihmonin menaxhimin e ngjarjeve të mundshme në kohën e duhur.

**Shkaku: -**

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** AKMC të marrë në konsideratë të gjitha mundësitë, për krijimin e një strukture të organizuar me të dhëna nga gjithë vendi, në lidhje me emergjencat civile, për të pasur më të lehtë vendimmarrjen në raste të ngjashme si dhe hartimin e politikave që do të ndiqen sipas ngjarjeve apo risqeve që prek çdo rajon në vendin tonë.

**6.Titulli i gjetjes.** Mungesë stafi, mjetesh dhe trajnimesh në emergjencat civile.

**Situata:** Nga auditimi mbi dokumentacionin vënë në dispozicion të audituesve nga strukturat e emergjencave që u vizituan në terren në: Prefekturat Tiranë, Vlorë, Lezhë Fier, Shkodër si dhe Bashkia Tiranë, rezulton se:

a. Nga 5 prefektura, në 3 prej tyre Shkodër, Vlorë, Fier nuk janë plotësuar vendet vakante duke rrisur në këtë mënyrë përmbyshjen e detyrimeve të këtij sektori me një rëndësi të madhe. Në Fier mungon përgjegjësi i sektorit dhe detyrat e tij i janë deleguar specialistit më me përvojë.

b. Strukturat e emergjencave civile në këto qarqe nuk kanë zhvilluar trajnime me tema të njëjta, dhe trajnimet nuk janë kryer në përputhje me risqet që paraqet secila zonë.

c. Asnjë ekspert i vendit tonë me njohje të mirë të risqeve natyrore nuk ka qenë referues në ndonjë temë trajnimi nga ato që na janë raportuar, me qëllim shkëmbimin e njohurive pse jo dhe përçimin e tyre. Përfshirja e ekspertëve në parandalimin dhe minimizimin e riskut konsiderohet e rëndësishme po aq sa në menaxhimin e situatave emergjente kur ato kanë ndodhur.

d. Të gjithë të intervistuarit nga audituesit në prefektura dhe bashki shprehen se kanë të njëjtat mjete komunikimi: telefoni personal, kompjuterët, e-mail dhe grupe në whatsapp. Regjistrimi i ngjarjes së ndodhur kryhet individualisht në Excel ndërsa ndjekja në kohë reale mbi sipërfaqen e një emergjence si prsh zjarr, përmbytje etj, rezulton se nuk mund të kryhet nga AKMC duke qenë se nuk disponon pajisje vëzhguese nga ajri.

**Ndikimi/efekti:** Vështirësi në menaxhimin e emergjencave në nivel rajoni

**Shkaku: -**

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:**

1. Prefekturat të marrin masat e nevojshme, për plotësimin e vendeve të lira në strukturat e emergjencave civile. Gjithashtu, të kontribuojnë në mënyrë proaktive në propozimin e temave të nevojshme për trajnim sipas ngjarjeve apo risqeve me të cilat ndeshen.

2. AKMC në bashkëpunim me strukturat e emergjencave në prefektura të analizojë të gjitha mundësitë, për pajisje monitoruese nga ajri, në shërbim të emergjencave të shpeshta që ndodhin



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË**  
**KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE**

në vendin tonë si zjarr apo përmbajtje si dhe zhvillimin e trajnimeve me tema të njëjta dhe të veçanta bazuar në ngjarjet që preket çdo rajon.

**Në lidhje me observacionet e dërguara nga Drejtori i Përgjithshëm i AKMC me shkresë përcjellëse nr. 83/2 prot, datë 29.04.2020, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 68/5 prot, datë 06.05.2020, mbi Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 68/4 prot, datë 16.04.2020, sqarojmë si më poshtë:**

Për sa i përket observacioneve të ardhura mbi projekt raportin e auditimit sqarojmë se janë paraqitur të njëjtat observacione identike në kontekst dhe përmbajtje që janë paraqitur edhe në fazën e Aktkonstatimeve të ardhura me shkresën përcjellëse nr. 6 datë 06.04.2020 të AKMC dhe protokolluar në KLSH me shkresën nr. 68 datë 10.04.2020. Shpjegimet përkatëse për të njëjtat observacione u është dhënë që në Projektraportin e këtij auditimi dhe argumentet tuaja janë trajtuar dhe pasqyruar në Projektraportin e auditimit me sqarimet përkatëse.



#### **IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se:

-AKMC nuk disponon apo administron sisteme të teknologjisë së informacionit dhe infrastrukturë network-u të sajën. Pajisjet fizike që disponon AKMC (*Pc, printer, router*), janë pjesë e infrastrukturës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe funksionojnë si pjesë e rrjetit të brendshëm të Ministrisë së Mbrojtjes. Suporti teknik, në hardware dhe software ofrohet nga njësia e IT në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes.

- Nga auditimi mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në AKMC për vitin 2019 u konstatua se ka pasur luhatje të vazhdueshme në burimet njerëzore, shoqëruar me vende vakante të strukturës në disa prej pozicioneve të rëndësishme në drejtoritë përkatëse, veprim i cili mbart riskun e mos përmbushjes së detyrave dhe funksioneve kryesore të Agjencisë. Në strukturën e re të miratuar të AKMC (miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 27, datë 03.02.2020) është parashikuar Sektori GIS, IT dhe Publikimit, në Drejtorinë e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit. Kjo strukturë duke qenë se është akoma në proces ristrukturimi dhe rekrutimi, nuk është plotësuar me punonjës/ specialist të teknologjisë së informacionit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet 10-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1 Rekomandim:** AKMC në bashkëpunim me MM në vijimësi të kryejnë analizimin dhe prioritarizimin e nevojave mbi infrastrukturën dhe elementet e nevojshëm TIK që ndihmojnë në lehtësimin e proceseve të aktivitetit që agjencia kryen.

**1.2 Rekomandim:** Strukturat drejtuese të AKMC në bashkëpunim me MM të marrin masa për mirë menaxhimin e burimeve njerëzore duke plotësuar vendet vakante dhe të hartojnë politika për zhvillimin e tyre nëpërmjet trajnimeve. Duke qenë se AKMC është në proces ristrukturimi të tregohet kujdes në rekrutimin e stafit të ri në mbështetje të strukturës së re duke patur parasysh fushat që mbulon mbrojtja civile.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, AKMC nuk ka strategji institucionale po ashtu edhe strategji për teknologjinë e informacionit, mungesa e të cilave sjell mangësi në vendosjen e prioritetëve, përqendrimin e energjisë dhe burimeve për të forcuar operacionet për të siguruar që punonjësit dhe palët e tjera të interesit po punojnë drejt qëllimeve të përbashkëta.

-Ndhima, mbështetja teknike dhe logjike për komunikimet e përditshme apo komunikimet me strukturat e tjera apo me institucionet bashkëpunuese, që ndihmojnë mbarëvajtjen e punës në strukturat e Agjencisë, kryhet nëpërmjet shkëmbimeve verbale, nëpërmjet celularit, whatsapp ose nëpërmjet e-maileve.

- Strukturat e emergjencave civile vuajnë nga koordinimi i dobët, mungesa e informacionit, e logjistikës, fondeve dhe kapaciteteve për të ndërhyrë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet 10-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1 Rekomandim:** Strukturat drejtuese në AKMC dhe MM, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni zotëron dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Institucionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit duke patur parasysh ndryshimet e ndodhura me aktet ligjore dhe nënligjore. Pjesë e këtij plani strategjik të bëhen edhe elementë të teknologjisë së informacionit.

**2.2 Rekomandim:** AKMC në bashkëpunimin me MM dhe me të gjithë strukturat e shërbimit të emergjencave civile të marrin masat për krijimin e mekanizmave të nevojshëm për automatizimin dhe ndërveprimin, komunikimin, shkëmbimit e ruajtjen e të dhënave ndërmjet strukturave të emergjencave civile bashkëpunuese në nivel qendror dhe rajonal.

*Menjëherë dhe në vijimësi*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, akoma nuk është draftuar/ hartuar apo miratuar, Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (*neni 10 i ligjit nr. 45 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”*). Ndërmjet reduktimit të rreziqeve nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile, më shumë prioritet i jepet të dytës. Reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë dhe mbrojtja civile i përkasin njëra-tjetrës si masa plotësuese, të cilat duhet të merren së bashku në mënyrë që të rritet qëndrueshmëria ndaj këtyre fatkeqësive.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet 10-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**3.1 Rekomandim:** AKMC në rolin e organit koordinues për menaxhimin e situatave të emergjencave civile, në bashkëpunim me MM dhe të gjithë palët e përfshira në proces të marrë masa për nisjen e konsultimeve me qëllim hartimin e dokumentit bazë strategjik të Republikës së Shqipërisë, Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, që përcakton politikat dhe aktivitetet e institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë, në përputhje edhe me përcaktimet e ligjit të ri “Për mbrojtjen civile”.

*Brenda vitit 2021*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, PKEC si dokumenti kryesor i politikave të shtetit shqiptar në fushën e emergjencave civile, për një kohë të gjatë nuk ka pasur asnjë përditësim, ku të pasqyrohen ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe në funksionet, kapacitetet dhe strukturat që bashkërendojnë veprimet e tyre në fushën e emergjencave civile duke mos iu përshtatur realitetit me ndodhitë që kanë ndodhur për 16 vite në Shqipëri. Plani është i bazuar në ligjin nr. 8756, datë 26.03.2001, “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, i cili me hyrjen në fuqi të ligjit të ri, së bashku me disa akte nënligjore ku mbështetet PKEC janë shfuqizuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet 10-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**4.1 Rekomandim:** AKMC dhe MM në bashkëpunim me strukturat përbërëse të emergjencave civile të marrin masa për përditësimin dhe miratimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile ku të pasqyrohen ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe në funksionet, kapacitetet dhe strukturat që bashkërendojnë veprimet e tyre në fushën e emergjencave civile duke u mbështetur edhe në ndryshimet e ndodhura me bazën ligjore dhe nënligjore.

*Brenda vitit 2020 dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, AKMC nuk ka zhvilluar dhe përcaktuar politika apo rregullore për mënyrën e menaxhimit, konfigurimit dhe përdorimit të teknologjisë së informacionit, ruajtjen e informacionit etj.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet 10-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1 Rekomandim:** AKMC në bashkëpunim me MM të marrin masa për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit të saj në nivel qendror dhe vendor, duke pasqyruar saktë dhe konkretisht rolet, detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e secilës strukturë përbërëse të saj, mbështetur edhe në përcaktimet e ligjit të ri “Për mbrojtjen civile” dhe strukturat e reja të miratuara.

*Brenda vitit 2020*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, AKMC nuk disponon regjistër risqesh institucional, ku të përfshinte edhe risqet mbi teknologjinë e informacionit, duke e bërë jo efektiv dhe jo eficient reduktimin e risqeve, në mospërputhje me nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, Udhëzimi i Ministrit të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet 10-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1 Rekomandim:** Strukturat Drejtuese në AKMC në bashkëpunim me MM të marrin masa për ndërtimin regjistrat të risqeve institucionale me qëllim që të identifikohen, analizohen dhe kontrollohen risqet, në mënyrë që mos të vënë në rrezik përmbushjen e objektivave të institucionit në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, në të cilin të përcaktohen edhe risqet IT.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua mungesa e vlerësimit kombëtar të riskut, i cili përfshin një vlerësim të klasifikuar të rreziqeve që mund të ndodhin në vend gjatë viteve të ardhshme, për të ndihmuar autoritetet përgjegjëse për të informuar, planifikuar dhe përgatitur mbi ngjarjet e ndryshme.

-Vlerësim i rreziqeve nuk përfshin një analizë të qartë, me skenarë të ndryshëm fatkeqësish dhe nivelet e ekspozimit të popullsisë dhe pasurive të saj ndaj secilit skenar. Strukturat e emergjencave civile i kushtojnë më shumë rëndësi reagimit pas ngjarjes dhe më pak komponentëve të tjerë.

-Nga auditimi u konstatua se, nuk janë identifikuar dhe dokumentuar në mënyrë të detajuar, infrastrukturat kritike vulnerabël mbi teknologjinë e informacionit dhe komunikimit sipas përcaktimeve të nenit 43 të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjes civile” mbi telekomunikacionin (rrjetet, sistemet).

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet 10-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**7.1 Rekomandim:** AKMC në bashkëpunim me MM dhe të gjithë palët e përfshira në proces të marrin masa për nisjen e konsultimeve me qëllim hartimin e dokumentit të vlerësimit të risqeve në nivel qendror, Vlerësimi i Riskut, që identifikon llojin, karakteristikën dhe prejardhjen e risqeve nga fatkeqësitë, nivelin e ekspozimit dhe të cenueshmërisë, faktorët që e shkaktojnë apo që e rrisin nivelin e mundësisë së rrezikut, si dhe pasojat e mundshme për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin. Futjen e burimeve të teknologjisë së informacionit në hartimin e politikave për burime njerëzore, burime të tjera materiale (*mjetet transporti, ushqime, mjete financiare etj*) për minimizimin e risqeve të mësipërme, në përputhje edhe me përcaktimet e ligjit të ri “Për mbrojtjen civile”.

-Ky dokument të paraprihet nga realizimi i studimeve dhe marrjes në analizë të shkaqeve të mundshme të ndodhjes së këtyre fatkeqësive, faktorët që ndikojnë në përkeqësimin e situatave dhe ekspozimit të popullsisë dhe pasurive të saj ndaj këtyre faktorëve, mundësive për shmangien e tyre, etj

**7.2 Rekomandim:** Gjithashtu, në vlerësimin e risqeve të identifikohen dhe merren në konsideratë edhe risqet e mundshme në infrastrukturat kritike të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si pjesë thelbësore e këtij procesi.

*Brenda vitit 2021*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se:

AKMC nuk ka të dokumentuar dhe implementuar procedura të standardizuara për kontrollin e ndryshimeve në infrastrukturën institucionale. Situata në AKMC dhe në strukturat rajonale nëpër Qarqe/Prefektura, për periudhën e audituar, menaxhohet mbi baza ngjarjesh. Nuk disponohet një procedurë për iniciimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë si dhe dokumentimin e të gjithë procesit të ndryshimeve, duke përfshirë dhe incidentet që vijnë nga ndërveprimi i të dhënave me institucionet bashkëpunuese apo pjesë të strukturave lidhëse.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet 10-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**8.1 Rekomandim:** Strukturat Drejtuese në AKMC në bashkëpunim me MM të marrin masa për hartimin e një plan veprimi për identifikimin, raportimin, trajtimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve. Gjithashtu të marrin masa për menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e të gjithë procesit të ndryshimeve.

*Brenda vitit 2020 dhe në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se zyra që përdoret nga Drejtoria Operacionale e Drejtimit Komandimit të Emergjencave Civile që ka funksion komandues, komunikues dhe koordinues në AKMC nuk ka infrastrukturën e nevojshme për monitorimin dhe koordinimin në kohë reale me anë të përdorimit të elementeve TIK. Gjithashtu struktura e drejtorisë për periudhën e audituar rezultoi me vende vakante. Ndërkohë komunikimi me autoritetet përkatëse bëhet me anë të aparateve celulare dhe me whatsapp.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet 10-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**9.1 Rekomandim:** AKMC në bashkëpunim me MM dhe të gjithë palët e përfshira në proces, në planin afatmesëm të investimeve, duke marrë në konsideratë burimet e nevojshme, të marrin masa për përmirësimin e infrastrukturës, duke krijuar një sallë operative moderne të qendëruar ku të realizohet koordinimi dhe monitorimi në kohë reale për të gjitha llojet e emergjencave në Republikën e Shqipërisë, në kohë normale dhe në kohë emergjencash, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit dhe qasjes proaktive duke u fokusuar më tepër në parandalimin dhe mbrojtjen ndaj emergjencave të mundshme, në sinkron me praktikatat më të mira si Emergency Response Coordination Centre (ERCC) dhe European Civil Protection and Humanitarian Aid Operations, struktura në të cilat ne aderojmë të anëtarësohemi.

*Në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Agjencia nuk posedon Portal Web të saj in por ka vetëm një seksion të posaçëm për Drejtorinë e Emergjencave Civile si strukturë vartëse e Ministrisë së Mbrojtjes.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet 10-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**10.1 Rekomandim:** Strukturat drejtuese në AKMC në bashkëpunim me MM të marrin masa për përmirësimin dhe përditësimin e faqes web të MM për seksionin e AKMC për të rritur ndihmesën dhe informimin ndaj qytetarëve, duke shtuar elementë inovativ në faqen web për ta bërë atë sa më interaktive dhe ndihmëse për qytetarët. Në të ardhmen, nëse do të jetë e mundur, agjencia kombëtare e mbrojtjes civile për nga vetë rëndësia që ka, të ketë një portal web informues me të gjithë elementet që parashikon ligji i të drejtës së informimit.

*Brenda vitit 2020 dhe në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi infrastrukturën kritike u konstatua se nuk janë marrë në konsideratë bazat e të dhënave shtetërore, infrastrukturat e informatizuara dhe ajo e qendëruar në Data Center-in e vetëm që administrohet nga AKSHI, përcaktuar në nenin 43 të ligjit nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile” si infrastruktura kritike.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet 22-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**11.1 Rekomandim:** AKMC të marrë në konsideratë si infrastrukturë kritike qendrën e të dhënave që administrohet nga AKSHI, në aktet rregullative që do të hartojë, si një sistem në të cilin jo vetëm është investuar një sasi e konsiderueshme fondesh të buxhetit të shtetit, por edhe pse është e vetmja formë për të ofruar shërbime në disa prej rasteve të emergjencave si: përmytje, zjarr, epidemi.

*Brenda vitit 2020*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se AKMC nuk ka ndërmarr asnjë hap komunikimi me AKSHI-n, nisur nga roli i saj parandalues, me qëllim:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

- a. Konsultimin mbi zhvillimin e teknologjisë apo sistemeve që do t'i shërbenin emergjencave civile në të gjithë strukturat e vendit.
- b. Identifikimin e infrastrukturës kritike si dhe risqeve në pronën shtetërore që AKSHI ka në administrim, si bazat e të dhënave shtetërore si dhe sisteme e infrastruktura të institucioneve dhe organeve të administratës buxhetore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave me anë të të cilave ofrohen dhe shërbime në distancë.
- c. Identifikimin dhe prioritarizimin e shërbimeve që mund të realizohen në distancë, në rastin e një emergjence civile.
- d. Hartimin e politikave dhe planeve për ofrimin e shërbimeve online në vend me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së shërbimit për shtetasit.
- e. Ndërtimin e një baze të dhënash me humbje nga fatkeqësitë si dhe impaktet prej tyre.
- f. Sigurimin se të gjitha institucionet dhe Agjencitë shtetërore që ofrojnë shërbime kritike nëpërmjet sistemeve elektronike si: kontrolli kufitar, kontrollet doganore, pagesat e thesarit, sistemi tatimor, sistemi i sigurimeve shoqërore, kujdesi shëndetësor, arsimit etj, kanë ndërtuar procese BCP/DRP si një detyrim për vazhdimësinë e shërbimit ndaj qytetarëve.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet 22-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**12.1 Rekomandim:** AKMC në bashkëpunim me AKSHI-n si institucion përgjegjës i zhvillimeve teknologjike të iniciojë identifikimin e infrastrukturave kritike, prioritarizimin e shërbimeve që duhet të ofrohen në distancë, garantimin dhe ruajtjen e të dhënave në sistemet kritike dhe çdo element i teknologjisë që nevojitet të jetë i vazhdueshëm në menaxhimin e një emergjence civile.

#### *Menjëherë*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga AKMC si dhe struktura të tjera në prefekturat e vizituara gjatë këtij auditimi, u konstatua se:

- a. Nuk disponojnë plane evakuimi të miratuara, plane rikuperimi apo plane vazhdimësie në asnjë prej niveleve kombëtar, rajonal apo lokal.
- b. Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga AKMC si dhe struktura të tjera në prefekturat e vizituara gjatë këtij auditimi, u konstatua se, nuk janë identifikuar proceset kritike si dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit sipas llojit të fatkeqësisë, nuk ka plane apo politika mbi mënyrën se si do të ofrohen shërbimet në rast ndërprerjeje.
- c. Bashkëpunimi ndërmjet subjekteve shtetërore dhe private bazuar në nenin 14, pika 8 të ligjit nr. 45, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”, ende nuk ka filluar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet 22-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**13.1 Rekomandim:** AKMC të marrë masat e nevojshme për identifikimin e proceseve kritike që sigurohen nëpërmjet teknologjisë së informacionit, si shumë të rëndësishme në rastin e emergjencave civile shkaktuar nga epidemitë. Gjithashtu, të hartojë apo kërkojë nga institucioni përgjegjës për teknologjinë AKSHI, planet dhe politikat e vazhdimësisë në ofrimin e shërbimeve në rast emergjence.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se:

- a. Mungojnë identifikimi i risqeve dhe protokolle të komunikimit për risqet e identifikuar nga emergjencat civile. Një protokoll i nisur ka mundësi të përmirësohet, por një protokoll komunikimi ende i pa nisur, pengon në kohë përballim e çfarëdo situatë emergjente që mund t'i duhet të kalojë vendit tonë në nivele të ndryshme lokal/ rajonal/ kombëtar.
- b. AKMC nuk disponon protokolle komunikimi të dokumentuara sipas ngjarjeve të caktuara që përcakton ligji, të cilat lidhen me dukuri natyrore ekstreme si: tërmetet, përmbytjet dhe vërshimet e ujit, temperaturat ekstreme dhe të tej zgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët,



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

erërat e forta në tokë dhe në det, zjarret masive në pyje, sëmundjet infektive masive dhe dukuri të tjera që ndikojnë në jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet 22-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**14.1 Rekomandim:** AKMC të marrë masa për hartimin dhe miratimin e protokolleve të komunikimit ndërmjet institucioneve si dhe krijimin e dokumentacioneve model, që do të përdoren në secilën prej emergjencave që do ndeshen në të ardhmen në secilin prej niveleve.

#### *Menjëherë*

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se AKMC nuk disponon regjistër ngjarjesh të konsideruara emergjente të ndodhura apo të raportuara sipas shpërndarjes gjeografike, që ato kanë pasur brenda vendit. Të dhënat e pakta në excel të regjistruara janë nën përgjegjësinë morale të çdo punonjësi në strukturat rajonale. Grupi i auditimit vuri re se vetë punonjësit në Fier, Tiranë, nën përgjegjësinë e tyre individuale kanë regjistruar të dhëna për aq kohë sa ata kanë në kryerjen e detyrës së lidhur me emergjencat, por nuk disponojnë të dhëna nga e kaluara.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet 22-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**15.1 Rekomandim:** AKMC të marrë në konsideratë të gjitha mundësitë, për krijimin e një strukture të organizuar me të dhëna nga gjithë vendi, në lidhje me emergjencat civile, për të pasur më të lehtë vendimmarrjen në raste të ngjashme si dhe hartimin e politikave që do të ndiqen sipas ngjarjeve apo risqeve që prek çdo rajon në vendin tonë.

#### *Brenda vitit 2020*

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi dokumentacionin vënë në dispozicion të audituesve nga strukturat e emergjencave që u vizituan në terren në: Prefekturat Tiranë, Vlorë, Lezhë Fier, Shkodër si dhe Bashkia Tiranë, rezulton se:

- Nga 5 prefektura, në 3 prej tyre Shkodër, Vlorë, Fier nuk janë plotësuar vendet vakante duke rriskuar në këtë mënyrë përmbushjen e detyrimeve të këtij sektori me një rëndësi të madhe. Në Fier mungon përgjegjësi i sektorit dhe detyrat e tij i janë deleguar specialistit më me përvojë.
- Strukturat e emergjencave civile në këto qarqe nuk kanë zhvilluar trajnime me tema të njëjta, dhe trajnimet nuk janë kryer në përputhje me risqet që paraqet secila zonë.
- Asnjë ekspert i vendit tonë me njohje të mirë të risqeve natyrore nuk ka qenë referues në ndonjë temë trajnimi nga ato që na janë raportuar, me qëllim shkëmbimin e njohurive pse jo dhe përçimin e tyre. Përfshirja e ekspertëve në parandalimin dhe minimizimin e riskut konsiderohet e rëndësishme po aq sa në menaxhimin e situatave emergjente kur ato kanë ndodhur.
- Të gjithë të intervistuarit nga audituesit në prefektura dhe bashki shprehen se kanë të njëjtat mjete komunikimi: telefoni personal, kompjuterët, e-mail dhe grupe në whatsapp. Regjistrimi i ngjarjes së ndodhur kryhet individualisht në Excel ndërsa ndjekja në kohë reale mbi sipërfaqen e një emergjence si prsh zjarr, përmytje etj, rezulton se nuk mund të kryhet nga AKMC duke qenë se nuk disponon pajisje vëzhguese nga ajri.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet 22-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**16.1 Rekomandim:** Prefekturat të marrin masat e nevojshme, për plotësimin e vendeve të lira në strukturat e emergjencave civile. Gjithashtu, të kontribuojnë në mënyrë proaktive në propozimin e temave të nevojshme për trajnim sipas ngjarjeve apo risqeve me të cilat ndeshen.

#### *Menjëherë*

**16.2 Rekomandim:** AKMC në bashkëpunim me strukturat e emergjencave në prefektura të analizojë të gjitha mundësitë, për pajisje monitoruese nga ajri, në shërbim të emergjencave të



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË**  
**KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE**

shpeshhta që ndodhin në vendin tonë si zjarr apo përmbytje si dhe zhvillimin e trajnimeve me tema të njëjta dhe të veçanta bazuar në ngjarjet që preket çdo rajon.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Me ndjekjen e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

*Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi*

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**